

# Dukagjini "Nderi i Kombit"



# Dukagjini


Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XVI i botimit, nr. 190, Gusht 2019

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355674001940, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Suela Ndoja, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

## I MADHI ISMAIL KADARE I PËRKET JO VETËM SHQIPËRISË, POR MBARË NJERËZIMIT

Alfred Papuçiu

Isha i ftuar, pas kthimit tim nga Shqipëria, nga profesori i shquar zviceran, mik i shqiptarëve, Jean-Philippe Assal. Në bisedë e sipër i thashë i entuziazmuar se pata fatin të takohem dhe të bisedoj edhe me shkrimtarin Ismail Kadare. Profesori i nderuar më foli me dashamirësi për shkrimtarin tonë mbarëkombëtar që e kishte takuar gjatë vizitës së tij, para disa vitesh në Shqipëri. Më pyeti si është me shëndet? Ju përgjigja që m'u duk tepër mirë, megjithë ngarkesën e madhe që përballon. Vetëm gjatë qëndrimit tim prej gjysëm ore, u bënë disa telefonata dhe bashkëbiseduesve të shumtë, ai u përgjigjej me respekt e dashuri. Kishte marrë çmimin e Princit të Asturias për letërsinë. Cmim që shpërblen gjithë veprën e tij. Ky çmim i jepet çdo vit që nga 1981 një njeriu « puna krijuese e të cilit përbën një kontribut të rëndësishëm për kulturën universale, në fushat e letërsisë ose të linguistikës ». Pak më parë kishte marrë edhe titullin « Doctor Honoris Causa » nga Universiteti i Palermos. Gazeta franceze "Le Monde" e cilëson veprën e tij në 100 më të mirat në botë. Shkrimtar i përkthyer në 40 gjuhë të botës. ...



## MËSUESI, SHKOLLA, LIBRI JANË TË PA ZËVËNDËSUESHËM

- BASHKËBISEDIM ME LUIGJ SHYTIN -

I dashur Luigj, mbas shumë përpjekjesh hulumtuese, ecje të pafund, studimore, takime e takime të pafund, shfletime e shfletime letrash, dokumentesh, gazetash deri në arkivat e shtetit për të nxjerr në dritë punën e 100 vjetëve në arsim e kulturë në Dukagjin, duke filluar nga viti 1917, nga i madhi At Shtjefën Gjeçovi dhe At Justin Rrota, më në fund e kurorëzove me sukses duke nxjerr librin me titullin e madh "Historik i Arsimit dhe i Kulturës në Dukagjin". Të lumtë mendja e dora për këtë ...

**Tani, si e ndjejnë veten Luigji?** Pas çdo botimi, autori ndjen kënaqësi, e ndijën veten një shkallë më lartë, të paktën në mendjen e tij, por për autorin çdo libër ka brenda pjesë, dhe jo pak, nga mendja dhe nga zemra e tij, ka mund dhe djersë. Natyrisht, vlerësimin e bëjnë lexuesit, veçanërisht ata që njohin mjedisin, për të cilin bëhet fjalë, që njohin kohën, terrenin, kushtet politike, social-ekonomike dhe natyrore, psikologjinë e njerëzve për ku shkruhet apo bisedohet. Në qoftë se botimi gjënë pëlqimin e tyre, autori, ndjen shumë kënaqësi.

## KAQ PAK MERITOJMË?...

Ndërsa po mendoja me vete procesin e fillim-ndalimit të punimeve në rrugën e Thethit, qindra mendime nga më të ndryshmet po më vërtiteshin e silleshin në koke, si bir i asaj zone, kjo ka qenë ëndërr, zhvillimi i zonës së Dukagjinit, duke filluar nga Thethi!

Ato 16 km rruge që i kam shkelur qindra, mijëra, miliona herë, herë në makinë e shumë shpesh në këmbë, që kur isha student e deri tani që ushtroj profesionin tim, i njoh kaq mirë, kaq imtësisht me çdo kthesë e tatëpjetë që kanë. Duket sikur qyteti i Shkodrës është i destinuar për të jetojë legjenda ...

## "MONOLOG ME VETEN"

MBRESA NGA LIBRI "MONOLOG ME VETEN" (KUR NUK KAM NJË PARTNERE PËR TË BISEDUAR) TË AUTORIT MERITAN SPAHIJA

Është një kënaqësi për mua që pata rastin të lexoj e të rilexoj librin "Monolog me veten - Kur nuk kam një partnere për të biseduar" të autorit Meritan Spahija. Autorin e nderuar pata fatin ta njoh gjatë punës në gazetën e përmuajshme "Dukagjini", ku tashmë është një mik i përbashkët. ...

## TRADITA E MARRJES SË FLOKËVE

(RRUARJA E FAMUJVE)

Marrja e flokëve (prerja dhe rruarja) nga kumbara ka qenë një ngjarje e shënuar në jetën e familjes dhe të fëmijës në veçanti. Mbasi fëmija mbushte tre vjet gjithmonë në stinën e dimrit, para motit të lidhur (i cili ndryshonte sipas kalendarit hënor, por gjithmonë pjesërisht i bije gjatë një pjese të Janarit dhe shkurtit) i merreshin flokët nga kumbara. Me këtë rast në shtëpinë famullit bëhej një ceremonie e veçantë festive. ...

## I VETMUARI I MADH, FREDERIK RESHPJA

Nga Bedri Islami

Rrallë Shqipëria ka pasur një poet të tillë, me fatin e tij të çuditshëm dhe tragjik; rebel në gen dhe paqtes në shpirt; i rënë në humnerë nga shpirti i tij dhe i ngritur në qiell përkohësisht, për të rënë edhe një herë në humnerën e tij, kësaj here përfundimisht; mjeshtër i fjalës dhe i pamundësisht i pandreqshëm; i adhuruar ...

# KAQ PAK MERITOJMË?...


Ndërsa po mendoja me vete procesin e fillim-ndalimit të punimeve në rrugën e Thethit, qindra mendime nga më të ndryshmet po më vërtitëshin e silleshin në koke, si bir i asaj zone, kjo ka qenë ëndërr, zhvillimi i zonës së Dukagjinit, duke filluar nga Thethi!

Ato 16 km rrugë që i kam shkëlur qindra, mijëra, miliona herë, herë në makinë e shumë shpesh në këmbë, që kur isha student e deri tani që ushtroj profesionin tim, i njoh kaq mirë, kaq imtësisht me çdo kthesë e tatëpjetë që kanë.

Duket sikur qyteti i Shkodrës është i destinuar të përrjetojë legjenda të tipit “ndërto ditën e prish natën”, ashtu si kështjella e Shkodrës, që çuditërisht muri prishej gjatë natës e u desh që për një kapriço të mallkimit a të fatit të zi të saj, të sakrifikohej e gjora grua, sot gjërat kanë ndryshuar paksa, sot për kapriçot egoiste të një gruaje sakrifkohet një komunitet i tërë.

Si një person shumë i interesuar, por edhe për shkak të detyrës që ushtroj kam marrë pjesë në të gjitha takimet që janë zhvilluar për projektin e rehabilitimit të aksit qafë T’Thore-Theth dhe si shumë të tjerë e kam pritur me padurim fillimin e punimeve.

Ndërkohë që, ashtu siç e do procedura, është miratuar projekti së bashku me fondin përkatës dhe në vitin 2018, konkretisht në datën 03.10.2018 Fondi Shqiptar i Zhvillimit i ka dërguar Marrëveshje Investimi për firmosje znj. Ademi, në cilësinë e Kryetares së Bashkisë Shkodër, përgjigje



e cila është kthyer në 19.07. 2019.

Do të doja që të rreshtoja pak gjëra:

- Bashkia Shkodër, NUK ka investuar asnjë lek për projektin, i cili po zhvillohet në terrenin që ka në administrim!
- Bashkia Shkodër, ka bllokuar punimet në ditën e dytë, nuk e di nga paaftësia apo dashakeqësia po!
- Bashkia Shkodër, NUK ka investuar

asnjë leke për zhvillimin e turizmit në Theth, një nga parqet kombëtare më të rëndësishme në Shqipëri.

- Bashkia Shkodër, nuk menaxhon mbetjet në qendrën e fshatit, as me minimumin ose vendosjen e kontinierëve, që nevojiten dhe mbledhjen e këtyre të fundit!

-Bashkia Shkodër, NUK kanë marrë

asnjë masë për përmirësimin e transportit publik duke e klasifikuar nga turistët vendas dhe të huaj udhëtimin për në Theth, si eksperiencë të pasigurte dhe të ç’organizuar .

- Bashkia Shkodër, NUK kanë marrë asnjë masë për menaxhimin e Qendrës së Vizitorëve në Theth, edhe pse vizitohet nga qindra turistë në ditë!

Ka kaq shumë që Bashkia Shkodër, NUK ka.....!

Por dhe Qeveria qendrore, NUK ka.....!

Pse .... apo se .... shumë dilema kam në kokë ..

Ku mund të pyes ... ? Ku ta marr një përgjigje ...? ASKUND....., por jam përsëri krenar që jam dukagjinias..

I them këto, sepse nuk e meritojnë Dukagjini gjithë ketë, NUK ka....

Tani, të diskutosh rrugën e Thethit, është një pike ujë në det, me ato që do të duheshin të jene në atë zonë.

Unë, dal shpesh në vendlindjen time se e dua, por ende po përrjetoj errësirën?!

E qirinjtë, që duhen për të ngrenë darken bujare, sikur nuk...

Sa shumë do të doja ta shikoja atë zonë me rrugë, me drita, me jetë, me gjallëri, me arsim, me mjekësi, eee me të gjitha, qe i duhen njeriut!

Ato, që njeriu mund të bëj, sepse Zotit nuk kemi çfarë ti kërkojmë më shumë, se të gjitha na i ka dhanë pa ja kërkuar!

Ëndrra vijon ...

**Nga Agim Dardha**

## “KËSHTU ËSHTË E SHKRUAR”, ËSHTË LIBRI FOTOGRAFIK MBI JETËN E BANORËVE TË DUKAGJINIT, I PËRKTHYER NË KATËR GJUHË, NË EVROPË DHE NË KINË

“Kështu është e shkruar”, titullohet libri i autorit anglez Rhodri Jones, që mbërrin në Shqipëri, në vitin 1992, në të cilin përgjatë 10 viteve përshkruan jetën e banorëve të Dukagjinit. Ai, nuk është më i vetëm, një i huaj, por krejtësisht i përfshirë në raportet shoqërore delikate të mbrojtura në shekuj. Shikon me sytë e tij se si jeta e përditshme përcaktohet prej disa rregullave që, kur bëhet fjalë për gjykimin e çështjeve të ndryshme, i kapërcejnë kufijtë e vullnetit individual.

Rhodri Jones gjendet i rrethuar nga rituale, që e bëjnë të ndjejë një njeri të ca kohërave të tjera. Në imazhet e tij dëshmojnë të gjitha aspektet më të rëndësishme të jetës shoqërore në malësi: puna e rëndë e mbështetur tek agrikultura dhe blegtoaria, aspektet fetare të banuarit në shtëpi të thjeshta prej guri, pothuajse pa kurrfarë mobilje brenda, kremtimet e morteve.

Rroli i femrës në një shoqëri ku mar-

rëdhëniet farefisnore njohin vetëm gjendjen e meshkujve, gruaja i nenshtrohet shpesh herë martesave të përcaktuara dhe tërë jeta e saj rrotullohet brenda kufinjve të përcaktuar rreptësisht.

Qëndrimi i Rhodri Jones, të parit të huaj, që shkel në zonat e thella malore të Dukagjinit, që prej Luftës së Dytë Botërore, është i privuar nga gjykimi në mënyrë konsante dhe për më tepër i mbushur me respekt për këta njerëz me respekt kaq të vërtetë, të vuajtur dhe dinjitoz, që përballojnë me kryet lart sfidat e veta.

Pikërisht për këtë gjë pranohet dhe çmohet roli i tij dhe puna e tij dokumentuese, e cila jo vetëm që nuk bëhet pengesë, por kontribuon për ngjizjen e kujtesës historike të çdo familjeje.

Pamje e të rinjëve të vranë dhe burrave që rrokin kallashnikovin në jetën e përditshme, fytyrat e gërryera nga stërmundimi dhe kequshqimi, varfëria, ashpërsia



Gjama e burrave e mbajtur për nder të Martin Camaj, në shtëpinë e familjes së tij, në Telumë, Temal, 1992, nga Rhodri Jones

e kushteve femërore, sikurse gëzimi dhe bragtisja e çasteve festive, kane një vlere, që për mendimin tim, shkon përtej aspektit dokumentues, të cilin autori i tyre e konsideron si themelor: imazhet bëhen metafora të jetës njerëzore në thjeshtësinë e saj.

Në këto imazhe rigjejmë rrënjët tona, që na tërheqin dhe na zmbropsin prej vetes njëkohësisht.

Në këtë libër fotografik pasqyrohet jeta e banorëve të Dukagjinit, në 51 fotot e publikuara, tashmë i botuar në katër gjuhë: shqip, anglisht, italisht dhe në

gjuhën kineze.

Miku im Rhodri Jones duke shndërruar aparatit fotografik në një mjet zgjerues të ndjeshmërisë së tij ndaj subjekteve, arrin që të kape, si askush tjetër para tij, shpirtin krijues të këtyre njerëzve.

Ky libër fotografik gjendet në fototekën Marubi, në Shkodër dhe falë mundësive të kompanive kineze, gjendet edhe në Republikën e Kinës.

*Pëgatiti Zef Nika, Bruksel*

# MËSUESI, SHKOLLA, LIBRI JANË TË PA ZËVËNDËSUESHËM

- BASHKËBISEDIM ME LUIGJ SHYTIN -

I dashur Luigi, mbas shumë përpjekjesh hulumtuese, ecje të pafund, studimore, takime e takime të pafund, shfletime e shfletime letrash, dokumentesh, gazetash deri në arkivat e shtetit për të nxjerr në dritë punën e 100 vjetëve në arsim e kulturë në Dukagjin, duke filluar nga viti 1917, nga i madhi At Shtjefën Gjeçovi dhe At Justin Rrota, më në fund e kurorëzove me sukses duke nxjerr librin me titullin e madh "Historik i Arsimit dhe i Kulturës në Dukagjin".

Të lumtë mendja e dora për këtë arritje të madhe.

## Tani, si e ndjejnë veten Luigji?

Pas çdo botimi, autori ndjen kënaqësi, e ndijën veten një shkallë më lartë, të paktën në mendjen e tij, por për autorin çdo libër ka brenda pjesë, dhe jo pak, nga mendja dhe nga zemra e tij, ka mund dhe djersë. Natyrisht, vlerësimin e bëjnë lexuesit, veçanërisht ata që njohin mjedisin, për të cilin bëhet fjalë, që njohin kohën, terrenin, kushtet politike, social-ekonomike dhe natyrore, psikologjinë e njerëzve për ku shkruhet apo bisedohet. Në qoftë se botimi gjënë pëlqimin e tyre, autori, ndjen shumë kënaqësi.

Nga ana ime, jam ndjerë mirë me vlerësimet e bëra për botimet e mëparshme. Botimet janë ngjarje me rëndësi për autorin, sepse janë kurorëzim i një punë fort dashamirëse, por edhe me jo pak përpjekje, si nga ana e materialit, që merr në konsultim e referim, po ashtu edhe në gjetjen e vendit për ta çuar aty ku e ka vendin e duhur, për kohën e duhur. Natyrisht ndjem edhe më i moshuar, por s'kemi ç'ti bëjmë, por ndjem edhe më kërkues ndaj vetes, e kjo më bën, që edhe në analizën e një libri që lexoj, ti futem më thellë, në mënyrën time, për të parë se çfarë ka dashtë me thënë autori dhe çfarë ka thënë, sepse tjetër është çfarë ka dëshirë të thotë autori dhe tjetër është çfarë ka thënë në fakt. Moshë nuk është, dhe nuk duhet të jenë, pengesë për të mësuar gjatë gjithë jetës, pavarësisht flokëve të bardhë apo rrudhave në ballë ku vitet kanë lënë gjurmët e tyre të pakthyeshme.

**Ideja e realizimi është e madhe, por mendoj se është me interes të dihet, se si të lindi ideja e ndërmarrjes së kësaj pune hulumtuese e studiuase, për këtë temë kaq të madhe e të rëndësishme për arsimin e kulturën në tërësi për tërë vendin, por në rastin konkret, për Dukagjinin?**

Unë kam punuar për shumë vite në arsim dhe në drejtimin e shkollës 8 vjeçare dhe të mesme. Për 50 vjet të jetës time dhe mbi 33 vjet të punës kam jetuar dhe punuar në krahinën time, në Dukagjin, në fshat, me punën kulturore, por rreth 30 vjet në arsim, në disa shkolla të Dukagjinit si mësues dhe drejtues, veçanërisht në zonën e Pultit dhe të Shalës. Për shumë vite kam qenë drejtues rinie në zonën e Shalës, një punë vullnetare por shumë e bukur, me shumë veprimtari, e shumë lëvizje, që të jepnin kënaqësi të pashlyeshme. Puna dhe veprimtari më dhanë mundësinë për të parë, nga afër, gjendjen e nivelit arsimor dhe kulturor të bashkëfshatarëve të mijë, kulturën e jetesës, por edhe traditat në mënyrën e jetesës, bashkëpunimit, bashkëjetesës në bashkësi, traditat historike e kulturore, mënyrën e zgjidhjes së

mosmarrëveshjeve, e të tjera. Kam dëgjuar dhe kam parë në fëmijërinë time shumë që nuk dinin të shkruanin e të lexonin, madje kam parë njerëz që shkonin të ndonjë që dinte të lexonte në lagje, fshat, apo edhe te frati për të lexuar ndonjë letër që vinte nga pjesëtari i familjes ushtar, apo diku tjetër. Duke u rritur në moshë, pastaj duke punuar në arsim, por edhe duke ua përsëritur nxënësve, sa lejonte moshë e koha, ato që thash pak më lart, që të mund motivoheshin, dhe motivoheshin edhe ata, por edhe prindërit e tyre ndikonin edhe tek unë që të mos harroheshin, të ngulitej kërkesa "e heshtur, e pa kthjelluar mirë" për shumë kohë, për të bërë diçka për pasqyrimin e atyre përpjekjeve në një kohë shumë të vështirë për krahinën dhe vendin, në tërësi për të gjithë qenien tonë, por edhe se si në ato kohë me gjithë ato turbulenca politiko-ekonomike, krahas me kërkesat dhe dëshirën për liri e pavarësi, u ngjallë ndjenja e arsimimit, si njëra nga drejtimet më të rëndësishme, e

që kisha punuar dhe punoja, më pati thënë një herë, se pse nuk e bën një historik për arsimin në Dukagjin, pasi ke këto materiale. Unë i thashë se këto janë materiale dhe shënime personale dhe nuk mund të bëhet një historik vetëm me këto, nuk del i plotë dhe nuk mund të përfshijë gjithë atë punë të madhe që është bërë, dhe që nga vitet '60 i kam parë e kam marrë pjesë edhe vetë, por janë edhe shumë e shumë të tjerë që kanë punuar në frontin e rëndësishëm të arsimit dhe edukimit, ka shumë dokumente, të dhëna, e kujtime që i vlerësoja se duheshin për një gjë të tillë.

Ju, zoti Ndue, e dini shumë mirë, punën e vrullshme, dhe shumë të rëndësishme, që bëmë bashkë me Kryesinë dhe gjithë pjesëtarët e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", dhe jo vetëm, veçanërisht në 6-7 vitet e fundit, për ngritjen dhe vendosjen në Shkodër të monumenteve të Mehmet Shpendit dhe Martin Camajt, por edhe më parë me konferenca e simpoziume shkencore për Dukagjinin. Pasi mbaruam punë me këto monumente, në Kryesinë e Shoqatës shfaqëm mendimin për një konferencë shkencore për arsimin dhe kulturën në Dukagjin. Ne përpqeshim që ti merrnim gjerat në kohë dhe nuk i lamë për ditën e fundit. Puna filloi dy vite përpara kohës kur do të mbushej 100 vjet nga çelja e shkoll-

jetimet e bashkëkohësve, në fotodokumente e fotografi të ndryshme, apo në objekte. Për këtë duhej të kërkonim dhe të gjenim gjithë sa të mundnim materiale, që i shërbenin temës së çështjes.

Së bashku me Prelë Shytanin, e të tjerë filluam kërkimin në arkiva, duke shfletuar secili për temën e vet, shumë dosje, të shekullit të XX. Sa më shumë shfletonim e më shumë bindesha se duhet bërë diçka që këto të dhëna të mos mbylleshin, ndoshta përgjithmonë, të mbetej e fshehur ajo punë e vlefshme e bërë. Askush nuk duhet të mendojë se ne arritëm majat më të larta, bëmë gjera të jashtëzakonshme. Ne bëmë atë punë që duhej bërë për krahinën tonë, u përpoqëm që të pasqyrojmë atë punë të madhe që bënë paraardhësit tonë mësues e drejtues në arsim, dhe arritëm ato që janë publikuar më në fund. Kjo nuk ishte aspak e vogël që në një vend shumë të thellë malor, larg jetës urbane, e izoluar nga politikat dhe administrimi i kohëve, por dhe i vetë izoluar për të mos u shkërmoqë nga pushtimet, reprezaljet, veprimet dhe ndikimet e tyre. Nuk është pak që një vend plotësisht analfabet që e gjeti Pavarësia e krijimi i shtetit shqiptar, pesë vjet më vonë fillon hapja e shkollave në gjuhën shqipe.

Pas një pune këmbëngulëse u grumbulluan shumë materiale, u panë shumë

**Luigj Shyti**

Është lindur më 23 mars 1948, në Theth. Shkollën fillore dhe shtatëvjeçare e ka kryer në fshatin e lindjes. Ka mbaruar Shkollën e Mesme Pedagogjike në Shkodër, si dhe Institutin e Lartë Pedagogjik, në Shkodër, dega Bio-Kimi. Ka afër 50 vite punë, 45 nga të cilat në arsim. Për 32 vite, deri në daljen në pension, ka qenë drejtor në shkollë 8-vjeçare dhe të mesme. Si mësues dhe drejtor, ka punuar në Plan, Murgull, Breglami, Abat, Nicaj-Shalë, Nderlyse, Theth, Vellojë, Karmë, Gur i Zi, Rrugam - Gur i Zi. Që nga 1970 ka botuar dhjetra shkrime informative, editoriale, problemore, studime, portrete, poezi etj., në shtypin e kohës, lokal dhe qendror. Kujdes të veçantë i ka kushtuar botimeve në gazetën "Dukagjin". Është bashkëpunëtor në botimin e guidës turistike "Parku Kombëtar Theth" - 2000. Është organizator i botimit me poezi "Dritë Dashuric" - 2004. Është nisimtar për krijimin e Shoqatës Atdhetare "Dukagjin" dhe sekretar i saj për 15 vite. Është nisimtar në themelimin e gazetës "Dukagjin", anëtar i redaksisë që nga themelimi dhe disa vite kryeredaktor i saj.

**Ka botuar:**

- Dukagjini ka vend për të gjithë (publicistikë)- 2005
- Gjurmë, syzime etnografike në Dukagjin- 2007
- Meq e mira n'ortek Çborës (këngë të buta në Dukagjin)- 2009
- Lamtumirë mos thuar, vëllim me poezi- 2011
- Dukagjini, rrugtim në gjenezë- 2014
- Historik i Arsimit dhe i Kulturës në Dukagjin- 2015

**Historik i Arsimit dhe i Kulturës në Dukagjin**

**Luigj Shyti**

**Çmimi: 1000 lekë**

cila do të mund tu hapte rrugën e të gjitha drejtimeve të tjera të zhvillimit dhe përparimit të vendit. Gjithnjë erdhi duke mu mbushë mendja që të përpqesha të bëja një gjë të tillë, por, mjaft ngadalë. Gjatë punës time kam mbajtur shumë shënime edhe si mësues edhe si drejtues, ashtu siç kanë mbajtur dhe mbajnë shumë kolegë të mijë, mësues e drejtues, dhe mendoja se kam një informacion të vlefshëm, por sa më thellë futesha në problemet dhe punën e bërë në kohë të ndryshme për arsimin dhe kulturën, më dukej se dija më pak. Një shok i imi, jo mësues, kur më erdhi në shtëpi për vizitë, disa kohë më parë, dhe pa disa dosje vetëm për problemet e arsimit në shkollat

lave të para në Dukagjin. Pas diskutimeve në Kryesi, u vendos që të punonim për këtë Konferencë, duke e vlerësuar si një ri zgjim e vlerësim të historisë në këtë krahinë, u ngritën grupet e punës, u ndanë detyrat. Në mbledhje dhe takime në grupe pune, u diskutuan dhe u përcaktuan temat që do të mbaheshin në Konferencë, u ftuan mësues e ish mësues, punonjës kulture, por edhe nga terreni, drejtues të kohës, për të shkruar kujtimet e tyre, nga të cilat do të dilnin edhe nga ato që do të paraqiteshin në Konferencë. Kështu filloi puna për përgatitjen e saj. Nuk ishte aspak i lehtë realizimi i saj. Kërkohej punë kërkimore në arkiva të kohës, në biblioteka, në shtyp e kohës, në ku-

dokumente, u morën shumë skedime e të dhëna interesante. Pra, u krijua mundësia për zhvillimin e Konferencës Shkencore për këtë problem. Por të gjitha ato materiale që u grumbulluan, në imtësi nuk mund të paraqiteshin në Konferencë, për arsye kohe, madje disa duhej që të krahasoheshin dhe ballafaqoheshin me dokumente e fakte të tjera. Gjithsesi pas përgatitjes së kujdesshme në bazë të një programi të përcaktuar deri në detaje nga Kryesia e Shoqatës, u zhvillua Konferenca në një nivel të lartë nga përgatitja, nga pjesëmarrja si dhe nga disiplina shkencore. Punë e kujdesshme u bë për përgatitjen e botimit e materialeve të Konferencës. Doli një

botim mjaftë serioz dhe i kërkuar nga lexuesit, veçanërisht nga ata që kanë punuar dhe punojnë në frontin e arsimit dhe të kulturës në Dukagjin dhe për Dukagjinin, por edhe studiues të ndryshëm.

Përgatitja e zhvillimi i konferencës, referatet, kujtimet e të tjera që u paraqiten në Konferencë, ishin të rëndësishëm për mua që të merrem me përgatitjen dhe botimin e një Historiku për arsimin dhe kulturën në Dukagjin, ku do të dilnin më shumë të dhëna, më shumë analiza, do të mund të pasqyroheshin sa më shumë, ata që kanë punuar e drejtuar apo punojnë dhe drejtojnë akoma në shkollat e Dukagjinit, por edhe problemet në kohë të ndryshme, vështirësitë, marrëdhëniet shoqërore, kushtet e jetesës, puna kulturore si një aspekt i pandarë nga shkolla dhe mësuesit. Mu gjendën pranë shumë koleg e bashkëpunëtorë, me të dhëna, foto e dokumente. Kjo më dha më shumë zemër për përgatitjen e këtij botimi, me dëshirën që ajo punë e bërë të mos harrohet e humbasë në terrin e mjegullnajën e kohës. Në këtë botim nuk është bërë e mundur që të thuhet gjithçka, por është thënë shumëçka.

Në mes të tjerave ndaleni në një pjesë të librit, për punën e priftërinjve katolik për ndriçimin e mendjes së malësoreve ... Pse e keni veçuar, që në fillim të librit ketë çështje? Cili ishte roli i tyre në mbajtjen gjalle të gjuhës shqipe dhe pse ishte e ndaluar me dekret të veçantë nga sultanati?

E si mos të veçohet puna e priftërinjve gjithmonë, dhe veçanërisht edhe për këto momente. Kleri në krahinën tonë ka qenë gjithnjë në frontin e parë për edukimin e popullit me të gjitha cilësitë e mira, për të ruajtur historinë e kulturën, gjuhën shqipe, edukatën familjare, dashurinë për atdheun, e elementë të tjerë. Në të gjitha kishat bëhej një punë e organizuar me masën e të rinjve. Grumbulloheshin pranë saj, edukoheshin me besimin fetar, por edhe zhvillonin veprimtari kulturore interesante, të cilat shfaqeshin, pranë kishës, përpara prindërve të tyre në ditë festash e festimesh. Pranë kishave janë hapur edhe shkolla të niveleve të ndryshme të cilat ndihmuan në ruajtjen e gjuhës shqipe. Mbase jo gjithmonë dhe në çdo vend mësonin shkrim e këndim, por edhe veprimtaritë edukative-kulturore qenë një ndihmë mjaftë e madhe për ruajtjen e gjuhës shqipe. Veçanërisht priftërinjtë që qenë shqiptarë bënë një punë mjaftë të madhe për ruajtjen dhe forcimin e gjuhës shqipe. Ndërsa po kërkoja në arkivin e Muzeut në Shkodër, në lidhje me një botim që kam bërë disa vite më parë, ish punonjësi i arkivit Paulin Pero, tashmë i ndarë nga jeta, dhe me kujdesin e tij të veçantë, më vuri në tavolinë një dosja jo të vogël, që mua më tërhoqi shumë sa më shumë shfletoja. Për mua, krejt rastësisht, pashë disa dokumente të viteve 1920-1922, por edhe të viteve të mëvonshme, veçanërisht nga fundi i viteve '30. Më tërhoqën aq shumë sa nuk di se si kaloj koha, veç kur më afrohet Paulini dhe më thotë se erdhi koha me dalë. E lamë për ditët në vijim, dhe ashtu bëmë. Aty pash rreth 40 dokumente origjinale që bënin fjalë për punën që po përpqeshin dhe arritën të bënin priftërinjtë e kësaj krahine dhe drejtuesit e tyre, duke marrë përsipër dhënien e mësimit në këto shkolla. Kishte dokumente me kërkesa për të hapur shkolla, për materiale shkollore, emërime të priftërinjve si mësues, lëvizje të tyre, e të tjera. E kam thënë edhe në libër, se këto shkolla që u hapën në Dukagjin nuk ishin

aspak private, as fetare, pavarësisht se jepnin mësim priftërinjtë e mësimi zhvillohej në mjediset e kishave, dhe as të panjohura për kohën, por mbetën të panjohura më vonë e veçanërisht pas çlirimit të vendit, kur kishte shumë mundësi. Ato të gjitha njiheshin nga shteti kohës, madje shpërblente më një farë subvencionimi ata që jepnin mësim. Dokumentet janë të thjeshtë, të shkruar shkurt, qartë, pa pompozitet dhe është interesante lëvizja e postës, për kohën, sa që brenda një jave çohet kërkesa e merrej përgjigja, me ja pasur lakmi edhe sot që teknologjia ka aritur lartësi të pa menduara.

Pastaj shkrimet në shtypin e kohës nga priftërinjtë e të tjera, në vlerësimin e shkollës, informacione për hapjen e shkollës, nevojat, sa të ishte e mundur për materiale shkollore në shërbim të mësimit, ecurinë e nxënësve në mësim, e të tjera. Ne duhet tu jemi shumë mirënjohës ndër breza, punës së bërë nga këta priftërinjtë, të cilët mbollën farën e mirë të arsimit dhe kulturës edhe në Dukagjinin tonë.

E kam shkruar prej disa vitesh, por dhe në këtë libër, se më ka bërë përshtypje të madhe, se si ka qenë e mundur që këto dokumente arkivore në Muzeun Shkodër nuk janë parë dhe publikuar. Unë, ruaj mendimin se ato janë parë, por nuk janë vlerësuar e publikuar, për vendin e kohës dhe realizuesit e asaj punë të vlefshme.

Ndër të tjera ndaleni në një pjesë të këtij libri, për punën e priftërinjve katolik, për ndriçimin e mendjes së malësorëve. I nderuar Luigj, ka mendime nga studiues të ndryshëm, dr. Mark Palnika, Prof. Dr. Lutfi Alia e të tjerë, se rrënjët e arsimit e kulturës sonë i gjejmë, që nga lashtësia e hershme, historia e zhvillimit të shkollave shqipe, dhe e arsimit në Shkodër që daton nga 1345-1395 dhe në Pult 1367, shkolla, këto, të hapura nga françeskanët arbëror dhe ata italian, që dinin gjuhën shqipe, pranë kishave e kuvendeve duke filluar nga shkolla në Ulqin e vitit 1258 dhe në vijimësi në Durrës 1278, Tivar 1349, Drisht 1396, Shtubëll, Dibër, Prizren, Shkup, Elbasan, Ohër, e të tjera. Madje dr. Mark Palnika shkon edhe më tej: "Në vitin 1675, në fshatin Rrjoll është hapur shkolla e parë shqipe me mësues Marin Gjinin, i cila ka punuar 22 vite Ipeshkëvi i Pultit, Në fshatin Xhan është krijuar kori i vajzave, në Kabash para vitit 1400 ka pasur shkollë të nivelit të mesëm. Cili është mendimi juaj?"

Kam parë disa prej këtyre publikimeve dhe janë shumë interesante. Janë interesante për dëshirën për të ecur në drejtimin e duhur, gjithnjë drejt zhvillimit e përparimit, për më shumë shkollë dhe kulturë, duke vlerësuar se shkollimi është bazë për zhvillimin e një populli, një vendi. Është e vërtetë që janë hapur shkolla shumë herët në Shqipëri, nga dhe pranë kishave. Këto shkolla ndihmuan shumë në mbrojtjen e gjuhës shqipe dhe të kulturës tonë kombëtare.

Priftërinjtë janë shkolluar në perëndim të gjithë, dhe kanë parë mundësinë e zhvillimit jo vetëm në shërbimin fetarë, por në të gjitha drejtimet për një jetë më të mirë, si e tillë edhe për shkolla në gjuhën amtare, si domosdoshmëri e pazëvendësueshme për të ardhmen e një kombi.

Priftërinjtë dhe kishat u bënë nismëtar dhe strehë e shkollimit në gjuhën shqipe. Sidomos në shekullin e XIX kishte shkolla, por nuk mësohej shqip. Shkrimtari ynë i madh, Ismail Kadare, na kujton se, në vitin 1887, kur u hap shkolla e parë shqipe, laike-shtetërore në Korçë, në Shqipëri

kishte 3000 shkolla, por vetëm ajo që u hap në Korçë ishte në gjuhën shqipe. Natyrisht, edhe në Konferencë, por edhe në botimin për të cilin po flasim jemi përqendruar në territorin e Dukagjinit të sotëm. Në mesjetë Pulti kishte një shtrirje shumë më të madhe se sa është sot Dukagjini. Është me vend të njohim dhe të vlerësojmë shumë punën që kanë bërë kishat dhe priftërinjtë në krahina tona, por edhe kudo, ndonëse nën presion të jashtëzakonshëm, ruajtën dhe përhapin gjuhën shqipe. Unë mendoj se duhet vlerësuar qofshin shkollat shtetërore, qofshin ato private që u vunë në shërbim të gjuhës shqipe dhe kulturës kombëtare. Pranë çdo kishë kishte grupe të fëmijësh dhe rinjsh e të rejash që mësonin këngë, dhe kryenin veprimtari kulturore pranë kishës në ditë festash dhe të kremtesh. Të gjitha këto bëheshin në gjuhën shqipe, në ato famulli që famullitari ishte shqiptar ose dinte gjuhën shqipe. Mësimi i këngëve bëhej përmendësh, jo se shkruheshin, pasi nuk dinin shkrim e këndim. Natyrisht kjo nuk ishte shkollë, por ishte një ndihmë e madhe për të ruajtur gjuhën shqipe nga ndikimet apo veprimet e pushtuesve të kohës, për ta bërë atë më të pranishme edhe në jetën kulturore të famullisë, nëpërmes të cilave vinte te veshi dhe mendjen e dëgjuesve nga ata që këndonin apo recitonin, gjuha shqipe më ëmbël, më bukur, që rriste dashurinë edhe për gjuhën por edhe për atdheun, tokën e të parëve.

**Mbas çlirimit të vendit u bënë përpjekje të mëdha, që quhet "Lufta kundër analfabetizmit" edhe ju e keni pagëzuar kështu. Pse u publikua aq shumë kjo nisëm sa edhe sot përmendet, madje më shumë të drejtë si një arritje e madhe dhe e veçantë dhe puna e atyre mësuesve dhe drejtuesve të kurseve që u vunë në krye të kësaj pune? Cilat ishin shkaqet, kur në zonën tonë shkollat shtetërore u hapën që në vitin 1917 dhe nuk duhet të kish analfabet?**

Shqipërinë, dhe, si pjesë e saj edhe Dukagjinin, e gjeti çlirim i vendit me një analfabetizëm të pashembullt në Ballkan dhe Evropë. Në këtë gjendje e kishin lënë regjimet që kaluan mbi truallin shqiptar. Dukagjini, në këtë kohë, kishte katër shkolla fillore, me 168 nxënës, ku jepnin mësim katër mësues. Koha kërkonte që njerëzit të dinin të shkruan dhe të lexonin, të paktën. Qysh në vitin 1941, Prof. Kolë Prela, i pushkatuar pak vite pas çlirimit nga regjimi që u vendos në Shqipëri, e quante analfabetizmin dëm për njeriun dhe kombin, dhe shtonte: "Anmiku më i madh i analfabetizmit asht shkolla ... Dije o shqiptar, se një analfabet s'ka pse pret dritë ma fort se i verbti të pamët ... shkolla asht lumnia, ndera e trimnia e një kombi". Duheshin kurse kundër analfabetizmit, që njerëzit të mësonin shkrim e këndim, të vihej në lëvizje rrota e historisë për më shumë dituri. Natyrisht nuk kishte ndonjë nivel të lartë shkencor, por të paktën të mund të përfitonin për të shkruar dhe lexuar.

Shtatë muaj pas çlirimit filluan kurset kundër analfabetizmit në Dukagjin. Gazeta "Koha e Re" e cila dilte në atë kohë, shkruan në korrik 1945 se filluan kurset kundër analfabetizmit në Dukagjin. Fillimisht kurset u vendosën pranë shkollave ku ishin të hapura, por dalëngadalë u shtrinë në të gjitha territorin. Ishte sanksionuar me ligj, që i detyronte shtetasit deri në moshën 40 vjeç të mësonin shkrim e këndim. Pati jo pak vështirësi, në bazë materiale, në mungesën e drejtuesve të kurseve, në koncepte frenuese, në largësinë e qendrave të kurseve

nga shtëpitë e banorëve, kushtet e punës në bujqësi e blegtori që vështirësonin pjesëmarrjen e kursistëve, e të tjera. Në përfshirjen në kurse u tregua kujdes i veçantë, për përfshirjen e vajzave dhe grave. Drejtuesit e kurseve kishin njohuri për shkrim, këndim dhe pak matematikë. Në nëntor 1946 – mars 1947 kishte 550 kursistë midis tyre 300 gra e vajza. Këtu, po flasim për Dukagjinin, por një punë e tillë u bë në të gjithë territorin e vendit. Për këtë është shprehur edhe ish Ministri i Arsimit të kohës, Thoma Deljana. Sipas dokumenteve të gjetura në Arkivin e Shtetit, në qershor të vitit 1948 kishte 31 kurse ku përfshiheshin 489 pjesëmarrës, midis të cilëve 355 ishin gra dhe vajza. Është vendi të përmendet se kurset kundër analfabetizmit ishte përpjekja e parë dhe shumë serioze edhe për emancipimin e grave e vajzave, në veçanti, krahas emancipimit të shoqërisë në përgjithësi, të një shoqërie që vinte nga një e kaluar shumë e vështirë në të gjitha drejtimet.

Gjithsesi, u bë një punë shumë e madhe në këtë drejtim, sepse shkollimi jo vetëm do të krijonte mundësi shkrimi e leximi, por sillte edhe emancipim të shoqërisë. Prej këtyre kurseve dolën kuadrot e para, që me kalimin e kohës e rriten nivelin e tyre arsimor nëpër shkollat pa shkëputje nga puna. Zhdukja e analfabetizmit u konfirmua zyrtarisht në vitin 1956, por lufta kundër tij vazhdoi dhe duhet të jenë nën kujdes edhe sot. E them këtë sepse nxënësit që braktisin shkollën e detyrueshme pa e përfunduar, janë kontingjent për analfabet, sepse në shumicën e rasteve, për të mos thënë të gjithë, e braktisin shkollën nxënësit me përparim të dobët. Raste braktisje ka edhe në Dukagjin, të njohura zyrtarisht. Kjo duhet të jenë objekt hulumtimi dhe korrigjimi, kryesisht nga shkollat prej të cilave janë larguar. E kam trajtuar në një nënkaptull për vetë punën e madhe që u bë në atë kohë për të mësuar dhe përhapur shkrimin dhe këndimin në gjuhën shqipe. Ishte një masivitet që meritonte vëmendje si vlerësim i punës së bërë, por edhe si një histori që duhej treguar brezave.

Është e vërtetë se filloj hapja e shkollave në vitin 1917, por ishte kohë turbullirash politiko-ushtarake, dikush hynte në Shqipëri e dikush dilte, brenda vendit nuk kishte stabilitet në jetën politiko shoqërore të vendit, qeveritë që erdhën në fuqi pas Kongresit të Lushnjës nuk u treguan të interesuara që të ndihmonte malësorët dukagjinas, që të forconin dhe përhapnin shkollat e punën e tyre. Madje ato u mbyllën disi pa zhurmë. Mbase, në këtë drejtim ndikoj edhe Lëvizja e Dukagjinit e vitit 1926, kundër regjimit të Zogut, që dihen pasojat e saj. Kjo çoj në analfabetizëm edhe më shumë banoret e Dukagjinit, për të mos thënë të gjithë, nga ata që kishin filluar të mësonin diçka. Me gjendjen e shkollave që u hapën, me frekuentimin jo të plotë të fëmijëve në moshën shkollore, nuk do të ishte e mundur zhdukja e analfabetizmit, por do të përfitonin një masë e madhe e fëmijëve malësor, e që do t'ja vliente për të ardhmen.

I nderuar Luigj, ju ndaleni në një pjesë të veçantë me titull "Arsimi në Dukagjin në vitet 1945-1990". A mund të na thuash diçka më shumë për veçimin e kësaj pjese?

Në qoftë se është bërë ndonjë punë e mirë, në Shqipëri pas çlirimit, ndër të parat, në mos më e para është shkolla dhe shkollimi në Shqipëri. Por "boshti ideologjik", pa tjetër, që ishte gjithmonë i pranishëm në mësim e shkollë, sepse

◀ e tillë ishte koha dhe ishte e pamundur dalja jashtë kësaj kornize. Çlirimi i vendit e gjeti edhe Dukagjinin në atë nivel shkollor, që u përmend pak më sipër. Por nuk është e vogël që një vend shumë i thellë e malor, larg jetës urbane, brenda 73 viteve, nga çelja e shkollave të para, të arrihet që në vitin 1990, vetëm në Dukagjin të ulen në bankat e shkollës mbi një e katërta e popullsisë, pa përfshirë ata që shkolloheshin jashtë Dukagjinit e familjarisht banonin në Dukagjin, dhe që ishin një numër i konsiderueshëm, sigurisht, mund dhe duheshin të ishin më shumë. Brenda kësaj periudhë pati një ndërprerje totale të shkollimit në Dukagjin, për 14 vjet, nga regjimi i Zogut.

U ngritën shkolla të reja mjaftë të mira, për kohën, në të gjithë territorin e Dukagjinit, u hapën shkolla fillore ku kishte grumbullim shtëpishë, madje edhe për katër nxënës e që kishin vështirësi për shkak kushtesh terrenit dhe atmosferike për të frekuentuar shkollën në largësi, si në Kaprrë, Mollë e Shoshit, Maja Thanës, e të tjera. U ngritën konvikte për grumbullim e nxënësve për tu krijuar mundësinë e shkollimit në një cikël më të lartë. I pari konvikt u hap në Xhan të Pultit, në të cilin u strehuan njëqind nxënës nga gjithë Dukagjini, por edhe nga Nikaj-Mërturi, në vitin 1946. Në fundin e viteve '60 u ngritën konvikte, në të cilat strehoheshin nxënës nga lagje apo fshatra në distancë të konsiderueshme, që nuk mund të vijonin shkollën 8 vjeçare nga shtëpitë e tyre. Konvikte u ndërtuan në Theth, Plan dhe Palaj-Shosh. Kjo vinte, se ishin ndërtuar shkollat e reja në qendra të mëdha, fillimisht, sepse nuk kishte mundësi ekonomike për ti ndërtuar të gjitha njëherësh. Konviktet ndihmuan që të gjithë nxënësit që mbaronin shkollën fillore të mund të vijonin shkollën 8 vjeçare. Konviktet vijuan deri sa u ndërtuan shkollat në të gjithë territorin, të cilat krijuan mundësitë e vijimit të shkollës 8 vjeçare të gjithë nxënësit nga shtëpitë e tyre.

Në vitet '80 filluan të ngrihen klasat kabine, dhe nxënësit lëviznin sipas orarit nga klasa në klasa. Kjo do të krijonte mundësi që mësuesi do të kishte të gjithë bazën materiale mësimore në klasë, dhe nuk kishte nevojë për tu bartë me harta, tablo, mjete demonstrimi në fizikë apo biologji e kimi nga klasa në klasë. Pa tjetër që nuk ishte e mundur në të gjitha shkollat, sepse se pari kërkohej hapësira e duhura dhe maksimumi i bankave apo tavolinave në çdo klasë, përveç të tjerave, por, sidoqoftë filluan dhe funksionuan me rezultat të mirë, atje ku u ngritën. Shembulli, ndoshta, më i mirë në vitet '80, qe shkolla 8 vjeçare në Theth.

Koha kërkonte më shumë shkollim në nivel më të lartë. Sytë u drejtuan te shkollat e mesme. Në vitin 1973 hapet e para shkollë e mesme bujqësore në Breglumi-Shalë, me konvikt. Katër vite me parë kishte filluar shkolla e mesme bujqësore pa shpëputje nga puna. Mësimi zhvillohej pasdite vonë, pasi mund të linin punën, por edhe mësuesit të ishin të lirë nga puna më nxënësit e ditës të shkollës 8 vjeçare. Mësimi jepej nga mësues të shkollës 8 vjeçare, sepse ishin të gjithë me arsim të lartë, por plotësoheshin edhe nga kuadrot specialist të kooperativës bujqësore apo të aparatit të Komitetit Ekzekutiv të Lokalitetit. Të bën përshtypje, që megjithëse hapej një shkollë në një zonë nga më të thellat në Shqipëri, me një prapambetje të madhe arsimore, dhe që ishte e para në zona të tilla, shtypi lokal, që dilte në atë kohë shkroi plot 112 fjalë ???!

Shkollat e mesme filluan të hapen edhe në zona të tjera si në Shllak, e disa vite me vonë, në Theth, Pog, dhe Ndreaj-Shosh. Morën arsim të mesëm qindra nxënës, nga këto shkolla, shkuan në shkollat e larta dhe jetëra student, që u diplomuan mjek, ushtarak, agronom, ekonomist, mësues, e të tjerë. Hapja e shkollave të mesme i dha gjallëri dhe shtysë pozitive, të fuqishme, gjithë jetës në Dukagjin.

Shumë nga këta nxënës u bënë drejtues në ekonomi e administratën shtetërore të kohës, por mund dhe duhej më shumë. Njerëzit po shkolloheshin, por me gjithë arrijtet, gjithsesi nuk ishte në nivelin e duhur dhe të mundur tërheqja e tyre në drejtim, në strukturat drejtuese, sidomos në bazë. Drejtuesit e kohës, natyrisht kishin fituar një farë përvojë, kishin bërë edhe punë të mira, por, përpjekshin të justifikoheshin me propagandën e politikës së kohës, dhe patriotizmin që manifestonin, por kjo nuk mjaftonte. Kjo vinte edhe pse nuk kuptohej nga shumë njerëz në ato vendet ku "ziente kazani", ku diskutoheshin, programohej dhe përgatitej gjithçka për në popull, por edhe ata që e kuptonin, se duheshin njerëz të shkolluar, duket se bënë sikur nuk e kuptonin, për të ruajtur karriget apo ndonjë privilegj moral apo material që kishin zënë. Prandaj kishte rezistencë jo të vogël për të përfshirë ata që kishin më shumë shkollë në jetën e fshatit apo krahinës. Kjo pa tjetër që solli ngadalësi në jetë shoqërore e në zhvillim. Qëndrime të tilla nuk ndodhën vetëm me ata që mbaronin shkollën 8 vjeçare, por po vijonte edhe me ata që mbaronin shkollën e mesme, caktoheshin brigadier në ndonjë qoshe në bujqësi apo blegtori, ndihmës llogaritar, ku shefi ishte me shkollë 8 vjeçare pa shpëputje nga puna, apo në ndonjë vend tjetër. Por edhe shikoheshin me "kujdes" që ti "edukonin". Po të futej më shumë shkolla në jetën shoqërore, pa tjetër që do të kishte edhe më shumë zhvillim, më shumë kulturë, më shumë e më shpejt emancipim të shoqërisë.

I dashur Luigj, sa është interesantë pjesa e parë "Arsimi në Dukagjin në vitet 1945-1990, jo më pak interesante është edhe pjesa e dytë "Jeta Kulturore Artistike në Dukagjin"! Pse vjen pas e dyta dhe nuk është vendosur në vendin e parë kjo pjesë e librit, pasi kultura popullore ka qenë shumë më e hershme, madje që me lindjen e shoqërisë njerëzore e organizuar në grup, e organizuar në bashkësi?

Po, kultura është e vjetër sa vetë jeta që nga shfaqja e njeriu të ditur në tokë. Secili brez ka zhvillimet e veta, e ato që janë parë të vlefshme kanë kaluar nga brezi në brez.

Transmetimi i përvojës nga brezi në brez është kolektivizëm (jo kolektivizim), është tregues vendimtar i edukimit, kulturës popullore. Në librin për të cilin po flasim, ka qenë e vështirë që të analizohet e përshkruhet gjithë ajo përvojë në shekuj e mijëvjeçarë të paraardhësve tonë. Nga ana tjetër për kulturën në Dukagjin nuk është shkruar pak, është shkruar nga studiues e udhëtarë, është shkruar nga priftërinjtë, është shkruar në vitet e fundit nga studiues e dashamirës të kulturës nga Dukagjini dhe për Dukagjinin, si Prof. Zef Gjeta, Voc Deda, Ndue Sanaj, Prelë Milani, Ledia Dushi, Lazër Kodra, Zef Lulash Sokoli e Lulash Gila, Ndue Cukeli, Kolë Funiçi, e të tjerë. Ku janë trajtuar tema e studime të mirëfillta, apo elemente të veçantë të kulturës. Unë, si pjesë e studiuesve dhe botuesve, nëse mund të jem i tillë, të bashkëkrahinarëve të mijë dukagjinas, jam përpjekur në të gjitha boti-

met e mija të trajtoj kulturën e zonës sonë sa më shumë në gjerësi dhe thellësi edhe në botime të veçanta. Në këto punime janë trajtuar ceremoniali i dasmës tradicionale, kultura popullore, etnografia, etnogjen-eza, folklori, ceremonia mortore tradicionale, elementë të veçantë të saj, e të tjera. Janë trajtuar shumë tema, e pa tjetër që ka shumë e shumë të tjera të vlefshme dhe interesante për tu trajtuar. Në botimin e këtij libri që po flasim, kultura është shënuar në pjesën e dytë. Kjo nuk është bërë aspak për mungesë vlerësimi, por e kam vendosur në këtë mënyrë sepse, këtu, kultura nuk është trajtuar si e tërë, por janë marrë elementë të veçantë të saj, të cilët janë pasqyruar në libër. Jo vetëm kjo, por edhe se për kulturën siç e thash pak më parë, është shkruar jo pak. Nga ana tjetër trajtimi në këtë botim është kryesisht në njëqind vitet e fundit, si dhe puna që është bërë nga fillimi i gjysmës së dytë të shekullit të XX e në vijim, si një punë më e organizuar, veçanërisht në elementë të veçantë të saj. Duhet të shënojmë se në këtë botim, arsimit ishte masiv, është hera e parë që problemet e arsimit trajtohen kaq gjerësisht, mbase kjo ishte ajo që vlerësova dhe më shtyri për këtë renditje. Po kujtoj këtu, se vetë shkolla dhe shkollimi janë pjesa më e organizuar dhe rrjedhojë e drejtpërdrejtë historikisht e kulturës. Mandej është krijuar një farë tradite, që kur flitet për këto dy degë, të cilat janë të një trangu, vazhdimisht thuhet "arsimi dhe kultura".

Me fillimin e hapjes së shkollave, edhe kultura mori një drejtim më të kualifikuar, u ndje puna e tyre. Por duhet theksuar se, pas çlirimit të Shqipërisë, ashtu si edhe vete shkolla, edhe puna kulturore u vu mbi baza më shkencore, më e organizuar, më masive, më e kualifikuar, gjë që çoi në një hop të zhvillimit të saj, nder të tjera edhe me veprimtari kulturore artistike, të cilat shkëlqyen në veprimtari lokale e kombëtare. Kjo traditë, tashmë, po vijon edhe sot e duhet të vijojë edhe në të ardhmen. Nuk është shumë e rëndësishme, mendoj, se si janë renditur kapitujt, por kryesorja është se janë në një botim të përbashkët.

Në pjesën e dytë të librit, keni veçuar një kapitull, me teme "Gazeta "Dukagjini" dhe puna e saj në shërbim të bashkësisë dukagjinase dhe më gjere". Mua me vjen mirë, që e keni veçuar, se është një punë jashtëzakonisht shumë e madhe, vullnetare, që është bërë në këto 16 vite nën drejtimin e kryesisë së Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", të anëtareve të redaksisë, të kryeredaktoreve Prelë Milani, Lazer Kodra, Luigj Shyti dhe tani të Suela Ndojes, por dhe të intelektualeve dukagjinase dhe jo vetëm pjesë e kësaj bashkësie, por që nga Australia e largët, SHBA, Kosova, Mali i Zi dhe po të thuash nga të gjitha hapësirat shqiptare, si dhe të mundësorëve të saj, por mundësisht desha diçka më konkrete për ndikimin që ka dhënë kjo gazete në bashkësinë tone dukagjinase?!

Gazeta "Dukagjini" është renditur në vijimin e botimeve të tjera që janë bërë nga dukagjinase dhe për Dukagjinin. E kam menduar dhe vlerësuar, në mendjen time, si nga botimet më masive, më të rëndësishme, më të bukur të kohës. Ishin këto që e vendosa në një vend të veçantë, por, besoj, të merituar.

Gazeta "Dukagjini", qe një domosdoshmëri e kohës. Dukagjini, në kohën që po projektohej kjo gazete dhe vetë shoqata, ishte tronditur, ashtu si edhe gjithë Shqipëria, nga vala e emigracionit, rrugë e pa rrugë, nëpër dete e avion, maleve me bore

e ujërave të rrëmbyer. U largua pjesa më e gjallë e jetës, mbetën shtëpitë vetëm me pleq të moshuar, më shumë si kujdestarë për shtëpitë se sa për punë. Ky emigracion edhe u pagua shumë shtrenjtë me jetë njerëzore. Emigracion pati edhe brenda vendit në shumicë të madhe. Secili ngulte gurin ku të mundte, dhe si e me se të mundte. Po bëheshin dhe duhet të bëheshin përpjekje për tu përshtatur kushteve të reja, dhe duhet të bëheshin. Vendlindja, pothuaj, u shkretua, në krahasim me atë që ishte më parë, e shumë e shumë probleme të natyrave të ndryshme. Në këto kushte po lindte Shoqata Atdhetare "Dukagjini", por kësaj i duhet edhe një lajmëtar i fuqishëm, një zëdhënës i dejë, për kohën dhe vendin, prandaj që në statutin e parë të saj u sanksionua se do të punohej për daljen sa më parë të një gazete, dhe kjo nuk vonoj dhe gjashtë muaj pas ligjërimit të shoqatës, doli numri i parë i gazetës "Dukagjini". Vërtetë ishte një ngjarje e jashtëzakonshme për vetë shoqatën dhe Dukagjinin. Personalisht jam ndjerë shumë i mallëngyer kur kam marrë numrin e parë të gazetës në dorë, kur ju zoti Ndue e sollët nga Tirana, sepse atëherë atje shtypej, sa dhe sytë mu kanë mbushë më lot gëzimi, kur i kam vënë buzët mbi të duke e puthur, që u realizua një detyrë nga më të rëndësishmet për shoqatën dhe komunitetin tonë e më gjerë, por edhe një dëshirë e imja e disa viteve më parë, por që në atë kohë mbeti e porealizuar. Ajo vijon punën sipas programit. Ajo nuk ishte dhe as nuk është gazete e politikës partiake, as private, as e pavarur, por është botim i kryesisë së Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", duke pasqyruar veprimtaritë e shoqatës, pjesëtarëve të saj, por edhe mjaftë më gjerë, në të mirë të zhvillimit, përparimit dhe emancipimit të shoqërisë tonë. Kjo gazete pasqyron dhe mbështetë, në mënyrën e saj të mundshme, politikën kombëtare. Gazeta, me sukses, ka ndjekur nga afër, sa ka qenë e mundur, edhe punën dhe jetën e bashkëkrahinarëve, vëllezërve dhe motrave tonë, të cilët morën rrugën e kurbetit, apo lanë disi trojet e të parëve dhe u vendosën në qytete apo afër tyre nëpër Shqipëri. U është bërë jehonë, është pasqyruar puna dhe jeta e tyre, problemet që i kanë shoqëruar, dhe ka dhënë ndihmesë në orientimin e zgjidhjes së problemeve. Është e vetmja gazete që del periodikisht, rregullit prej 16 vitesh në Shkodër, dhe prej shumë vitesh e vetmja gazete që del në Shkodër.

Gazeta "Dukagjini" ka një përhapje mjaft të gjerë. Ajo ka shkruar në shumë vende të Gadishullit Ilirik, në shumë vende të Evropës, në Amerikë, e deri në Australi. Kemi pasur dhe ka bashkëpunëtor të saj në të gjitha këto vende. Ajo vijon të mbetet si e domosdoshme në jetën e çdo dukagjinasi, në lidhjet e bashkëbisedimet e gjera dhe interesante, në njohjen e punës dhe veprimtarive të bashkëkrahinarëve dhe bashkëkombësve kudo ndodhen.

Kjo gazete ja ka bërë vendin vetit që të vlerësohet, edhe nga Këshilli Bashkiak i Shkodrës, edhe nga Unioni i Gazetarëve, edhe nga Këshilli i Qarkut Shkodër, pse jo edhe nga shoqata si motra, por mund dhe duhet të ishte vlerësuar edhe më parë, madje mund dhe duhet të kishin bashkëpunëtorët e vet me këtë gazete, me që pati dhe ka fuqinë që të jetë e vetmja gazete aktive në Shkodër, prej vitesh, e të tjera. Duhet lënë xhelozitë, sepse është fakt konkret puna e saj. Unë jam ndjerë mirë me botimin e daljen e gazetës, që isha nismëtar në daljen e saj, që isha vijimisht

◀ dhe jam redaktor i saj dhe për disa vite kryeredaktor i saj. Gazeta "Dukagjini" ashtu si edhe vetë shoqata, është punë kolektive dhe askush nuk mund ti shtrijë e futë duart, apo hundët, personalisht drejt saj.

E dua shumë dhe uroj të jenë jetëgjatë.

**Pasi jemi te puna dhe roli i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" nëpërmjet gazetës së saj "Dukagjini", mund të bisedojmë pak, mbi rolin e Shoqatës në nxitjen e punës hulumtuese, studiuere e botuese të intelektualëve Dukagjinin, si Luigj Shyti, Prele Milani, Lazer Kodra, Voc Deda e të tjerë e të tjerë? Mendoj, jo për të absolutizuar rolin e shoqatës, por nisëm dhe nga fakti, se hulumtuesi, studiuesi, krijuesi e botuesi Luigj Shyti, në vitin 2005, pas dy vjet të themelimit të shoqatës, më del me botimin e pare, me titull "Dukagjini ka vend për të gjithë, publicistike"?!**

Autorët që përmendni ju, pak më sipër, edhe të tjerë, janë kolegë dhe shokë e mijë, të mirë. Puna e tyre duhet përgëzuar dhe propaganduar se është e vlefshme për Dukagjinin, dhe më gjerë. Natyrisht secili ka drejtimin e vet, idenë e vet, mendimet e veta, mënyrën e vet të shprehurit, por që mbledhen në mullirin dukagjinin, që të bluj më mirë dhe më shumë.

Po, në Dukagjinin kanë vend të gjithë, kanë mundësi të gjithë, kanë hapësirë të gjithë, për të punuar, mësuar, për të fituar, për të shkruar, për të kënduar, nuk veçohet askush, dhe nuk duhet të ndodhë, asnjë zonë apo fshat qoftë i madh apo i vogël.

Kuptohet se mundësitë dhe hapësira është e kufizuar më hapësirën që zë në një territor. Nuk ka të njëjtën mundësi potenciale një vend, p.sh. me 200 banorë si një tjetër me 1000 banorë, në të gjitha drejtimet, por asnjërit nuk duhet ti mohohet e drejta, puna, pjesëmarrja, vlerësimi, sipas mundësive dhe aftësive.

Titulli i ati libri me publicistikë ka të bëjë në me disa shkrime, disi dualiste për probleme të ndryshme në Dukagjin. Kjo më shtyri që bëra një shkrim në gazetën "Dukagjini" dhe pastaj e përfshiva në atë botimin që përmendni ju. Mua nuk më duket i drejtë qëndrimi dualist midis fshatrave apo zonave, pasi nuk kemi asgjë të ndarë, jemi si një familje e madhe dhe e qëndrueshme e lidhur me qindra fije të fuqishme. Pa tjetër që ka dhe duhet respektuar të veçantat e secilës krahinë apo fshat, megjithëse këto janë shumë të vogla, madje mund të thuhet të pa rëndësishme në kontekstin e përgjithshëm jashtë krahinor.

Unë kam mendimin tim, por po e shpreh edhe si këshill, aq sa mund të vlejë si e tillë, për ata që do ta lexojnë. Nuk duhet të përpiqemi që të grumbullojmë pranë vetes, ose në rreth të ngushtë, shumë material, sepse nga grumbullimi bëhet një pengesë që nuk mund të shikosh se çfarë ka, apo çfarë bëhet përtej, më larg, ose, nga mbipe-sha krijohet një gropë, brenda së cilës i pari mund të bjerë ai që ka formuar grumbullin. Është mirë që "të hamë bukë dhe ti lëmë vend ujit", thotë një fjalë e urtë popullore. Të mos e bëjmë "boshtin mullar" se nuk shkon. "Uni" është për tu përdorur për të marrë përgjegjësi, nuk është shumë i vlefshëm për tu mburrur. Nuk rriten vlerat, apo emri i një vendi a i një njeriut pse shkruhet një libër voluminoz a pse këndohet një këngë, pse bëhet një reklamë a një promovim pompoz, por shkruhet libri apo këndohet kënga sepse e ka nxitur puna e tyre, djersa, gjaku, trimëria, vendosmëria, rezultati. Zbulimi dhe evidentimi në tërësinë e

tyre, i veçorive me përparësi, janë ato që bëjnë diferencën. Shkrimet, librat, këngët, nuk bëhen për të krijuar dhe ngritur heronjose heroizma, por janë këto të fundit, pra, heronjtë e heroizmat, që nxisin dhe duhet të nxisin për studime, libra, shkrime, këngë apo dokumentarë e filma. "Të gjithë meritojnë nga një qiri, por dikush prej dylli e dikush prej vijami" (parafine), kam dëgjuar një thënie të kahershme.

Për mua, të gjithë librat që botohen kanë vlera, kuptohet se dikush më shumë e dikush më pak. Nga ana tjetër shikohen botime që kanë jo pak të meta. Këtu është fjala për brendinë dhe mesazhin që bartin dhe jo nga ana teknike. Mirë është të mos kenë as të meta tilla, por një shkronjë e harruar nuk ja ndryshon brendinë librit. Por unë mendoj se të metat që mund të shikohen në një libër janë të ndara në gabime dhe fajë. Nga sa mendoj unë, të metat e natyrës teknike, pasaktësi apo shmangie, kur janë të pa qëllimshme, janë gabime. Ndërsa ato të meta që duken të qëllimshme janë fajë, kuptohet moralisht, sepse të gjithë kanë të drejtën të shkruajnë çfarë dhe si e mendojnë, e lexuesi, që është më gjak ftohtë, ka të drejtën e vlerësimit. Personalisht jam përpjekur dhe ja kam arritur që të shmangë gabimet e qëllimshme, të mos ulë dikë, apo diçka dhe të ngrë dikë apo diçka, të mos bëj apo të nxitë diferencime, apo hatër mbetje, me qëllim panegjirik, apo nënvlerësues.

Dukagjini është i pandarë në tërë qenien e tij, në histori dhe kulturë, në të folur, në etnografi, doke e zakone, në mjeshtri e ndërtime, në zhvillimin e kulturave bujqësore dhe të blegtorisë, dhe shumë e rëndësishme, ndërtimi i marrëdhënieve dhe organizimi i jetës shoqërore. Çdo përpjekje për të vënë vija ndarëse, për të bërë krahasime, për të tentuar ulje apo ngritje të paragjykuara, mendoj se nuk janë të vlefshme për sot as për të ardhmen. Askush nuk është i përkryer, askush nuk është pa të meta. Intelektualët, apo autorët e botimeve, duhet të synojmë të gjejnë linja që bashkojnë sa më shumë e sa më mirë.

Me pëlqen shumë qëndrimi i intelektualëve dhe autorëve të botimeve të komshinjeve tonë të mirë, Nikaj Mërturit dhe Malësisë së Madhe, që kurrë nuk lexova shkrime me tendencë dualiste, për fshatra apo zona të ndryshme, apo ballafaqime, edhe pse ka midis tyre largësi gjaku që vështirë të gjenden fjetet, apo besime ndryshe.

Dëshira për të hipur në kodër, për ta dalë në rojë, është vështirë të realizohet në tavolinë, nën hijen e mrizit, apo në freskinë e ortekut të borës në verë. Kjo është një farë trimërie pas lufte, apo urti pas kuvendit. Për të gjithë, dhe për të gjitha, është përcaktuar nga historia në kohë dhe hapësirë. Ajo ka përcaktuar vendin e secilit në kohën e duhur, në sasinë e duhur dhe në mënyrën e duhur.

Unë dëshiroj dhe bëj thirrje që të shkruhet sa më shumë, për persona, për vende, për objekte, për veprimtari të sotme dhe të kohës së kaluar, pa çka se sot mund të na duken të parëndësishme, të shkruhen dhe këndohen këngë sa më shumë të të gjitha gjinive dhe në mënyrën si tu shkojnë mendja autorëve. Pa tjetër mbi të vërteta. Koha do të jenë ajo që do ti seleksionojnë. Ajo është përcaktuesja me e drejtë dhe më e pamëshirshme, se kush meriton të jetojnë e kush duhet të harrohet. Një libër që del në treg, e nuk i referohet, qoftë, edhe një studiues, vjen duke u venitur e harruar. Një këngë mund të shkruhet, këndohet e regjistrohet, pra mund të rrojë në një arkiv, por

kur nuk e këndon populli, madje edhe duke harruar autorin, vështirë se do të quhet folklorike. Folklori është ruajtur e transmetuar në shekuj gojë në gojë, nuk është shkruar, por edhe autori nuk është kujtuar dhe nuk kujtohet fare.

Me që jemi në këtë pikë, a mund të mohohet, të nënvlerësohet, sepse për mbivlerësim nuk është nevoja, veprimtaria e shoqatës "Dukagjini" në këto vite, pavarësisht se jo të gjitha mund të pëlqejnë të gjitha veprimtaritë e saj. Natyrisht që jo, sepse e ka shkruar historinë e saj me punë konkrete.

Shoqata Atdhetare "Dukagjini" ka bërë, në vitet e jetës së saj, atë që nuk e ka bërë askush në historinë e Dukagjinit. Ajo nxiti veprimtari duke qenë edhe vetë aktor dhe faktor dhe realizoi detyra shumë të rëndësishme për historinë dhe kulturën, etnografinë, vlerat natyrore, turizmin, edukimi, emancipimin shoqëror, e të tjer. Pa asnjë farë hezitimi e them se kjo shoqatë, me veprimtaritë e saj, është bërë faktor për Dukagjinin, madje gjatë Konferencës që organizuam për arsimin një mik e shok pjesëmarrës, Alfred Haxhari, më tha: "Jeni bërë institucion".

Shoqata Atdhetare "Dukagjini", me punën dhe veprimtarinë e saj, ndihmoi në zgjimin e dëshirave për të hulumtuar dhe publikuar historinë, kulturën, etnografinë, natyrën, zhvillimin e krahinës, integrimin në jetën që jetojmë, në të gjitha ngulimet e vendbanimet e reja pas asaj dyndje marrendëse që u bë pas vitit 1990. Ndonëse askujt nuk ju vu detyra konkrete, që të merrej me një punë studimore e botime librash. Përfshij këtu konferencat e simpoziumet shkencore që kemi zhvilluar dhe duheshin organizuar në grup. Secili gjeti mundësinë e drejtimin, secili ju drejtua kujtimeve, shënimeve, skedimeve, secili përcaktoi temën, titullin, në pavarësinë dhe prorjen e vet. Dhe mirë u bë. Shoqata ndiqte, vlerësohte, mbështeste, promovonte, publikonte në gazetën e saj, por edhe në mediat elektronike lokale e kombëtare, në mbledhje e konferenca të ndryshme, në Kosovë, në Mal të Zi e të tjera. Të dalin në qarkullim rreth 200 tituj librash nga dhe për Dukagjinin, në të gjitha gjinitë, për periudhë relativisht të shkurtër nuk është pak. Kështu pra, shoqata ndikoj shumë në jetën kulturore shkencore për Dukagjinin dhe s'kishte si ndodhte ndryshme, pasi parimet e përgjithshme ishin përcaktuar qysh në themelimin e saj, në statutin dhe programin e saj afatgjatë.

Unë në këtë botim, për të cilin po flasim, nuk kam pasur qëllim për të shkruar historikun e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", por nuk kam mundur ta anashkaloj për vetë veprimtarinë, rolin dhe realizimet cilësore që ka pasur, u bë pjesë e fuqishme e jetës së dukagjinase, por edhe më gjerë. Historiku i kësaj shoqate, është mirë që të shkruhet, por fillimisht, mendoj, se do të ishte mirë të shkruhen dhe mbledhen kujtime rreth saj, foto, dokumente, pjesë nga jehona që ka bërë veprimtaria e shoqatës dhe që i është bërë këtyre veprimtarive, të shfrytëzohet arkivi i shoqatës, i cili, për kohën është shumë i pasur, dhe pastaj në mënyrë të qetë dhe me gjak të ftohtë të shkruhet historiku.

E kam thënë kohë më parë, dhe po e përsërisë me respekt, se ndjehem shumë mirë që isha nismëtar dhe pjesë e drejtimit për pesëmbëdhjetë vjet, dhe për të gjitha arritjet e saj. Mendoj se isha në kohën duhur dhe vendin e duhur, për të dhënë ndihmesën time për të dashurin dhe të paharrueshmin, Dukagjinin tim.

**Luigj im, mjaft keni hulumtuar, keni gërmuar e lexuar, mjaft të dhëna për arsimin keni grumbulluar dhe keni përplasur njëra me tjetrën për tu afruar sa më shumë të mundshmes së vërtetë. Ju lumtë! Në një rast më ka qëlluar të bëj debat me një intelektual kosovar, sepse ai kritikonte rininë sot, se është e pa ditur dhe nuk bën përpjekje për tu arsimuar. Në mes të tjerash atij i pata thënë, se nuk jam dakord me ty. "mua më ka qëlluar fati që në moshën 61 vjeç të mësoj kompjuterin dhe mësuesi im ishte në klasën e VI!" Nuk e di nëse e kam drejt idenë time, prandaj ju pyes, nga gjithë ky hulumtim e studim i juaj, mund të na thoni pak mbi shkollimin e djemve dhe vajzave dukagjinase sot?**

Ju, keni të drejtë të pyesni. Unë në studimin tim për arsimin dhe kulturën në Dukagjinin nuk e kam pasur të mundur që të merrem me përfshirjen e zhvillimit të shkencës dhe teknikës si dhe shtrirjen në shkollat e Dukagjinit, duke qenë se ka përfshi një periudhë në të cilën shkenca dhe baza materiale virtuale është përfshirë pak për mos me thënë aspak.

Djemtë dhe vajzat dukagjinase, ata që vazhdojnë shkollën në Dukagjin, kanë vështirësi natyrore, mungesa të bazës materiale shkollore, lokale shkollore jo të përshtatshme sa duhet për mësim, interesi i prindërve jo në nivelin e duhur, e kjo për shumë arsye të jetës ekonomike me vështirësi, e të tjera. Në këtë drejtim një detyrë shumë e rëndësishme u bie mësuesve që punojnë në këtë territor. Ata duhet të bëjnë më të mirën e mundshme për realizimin e programit mësimor. Nuk kam njohje se sa ndjehet ndihma dhe kontrolli nga drejtorët e shkollave apo zyrtarë arsimorë. Nuk kam dëgjuar që ti vizitojnë këto male inspektor të Ministrisë së Arsimit dhe të duket dora e tyre. Po kështu nuk kam ndjerë asnjë herë, këto vite, që inspektor të bashkisë për problemet e arsimit të kenë kaluar e ndihmuar këtë zonë, këta mësues e nxënës, të cilët kanë nevoja të shumta. Këto janë më shumë rëndësi, sepse vlerësimi dhe ndihma nga lart, shton punën në bazë.

Brezi i sotëm është në kushte shumë të ndryshme me kohën kur jemi rritur dhe shkolluar ne. Secili brez e ka për detyrë që të synojnë më të mirën për të tashmen, por edhe për perspektivën. Nuk është brez i mirë ai që bën çfarë të mundet për të jetuar mirë për vete, dhe që nuk mendon për fëmijët e tij, për brezat që vinë. Ai që kritikon rininë e sotme, i ka ra punës shumë shkurt, ka dashtë me dal në anë sa më shpejt. Po të shikojmë nga mundësitë materiale, mundësitë e komunikimit në të gjitha mënyrat, sot janë pa mbarim. Brezi ynë, e ata të mëparshmit edhe më shumë, kemi pasur kushte jo të mjaftueshme mësimi në shkollë e kushte të përshtatshme për studim në shtëpi. Familjarët e atyre kohëve e quatin të kryer detyrën me shkuarjen e fëmijëve të tyre në shkollë. Shumë, sot shkojnë në shkollë më makina, të veshur shumë mirë, të ushqyer po ashtu, me interesim prindëror shumë të madh, me përpjekje maksimale për tu lidhur me mësuesin e lëndës, mësuesin kujdestar, me drejtorin a nëndrejtorin. Të gjitha këto janë në favorin e mundësisë për të mësuar mirë e shumë mirë, për të frekuentuar shkollën pa asnjë mungesë të paarsyeshme e për sjellje shumë të mirë.

Sot, teknologjia ka arritur lartësi të pa imagjinueshëm më parë. Fëmijët, që në moshën 2-3 vjeç, e shikon ▶

me lojëra elektronike në dorë. Shikohen fëmijë të moshës së vogël shkollorë që përdorë bukur telefonin inteligjent, kompjuterin a mjete të tjera elektronike. Këto dhe shumë të tjera, pa tjetër, çojnë në zhvillim dhe përparim, njohjen e botës që na rrethon, njohje me të reja të shkencës dhe teknikës dhe vënia e tyre në shërbim të njerëzimit.

Pra, kushtet ekonomike janë plotësisht të përshtatshme për mësim dhe edukim maksimal. Sigurisht që ka shumë nxënës që kanë përparim të mirë dhe shumë të mirë në mësim, ka sjellje që të kënaqin, kanë veshje të pastër, kanë çantën me libra e pajisje të tjera dhe i mirë mbajnë ato. Shembuj pozitiv ka mjaft, por, kur përpikësh të bësh krahasime me kushtet që përmendëm dhe nivelin mësimor, këtu ka ngërç, sepse kurba e kushteve dhe ajo e përvetësimit të mësim, në mesataren e përgjithshme, nuk është e kënaqshme, frekuentimi po ashtu. Unë pretendoj frekuentim të plotë dhe cilësi më të lartë në përvetësimin e programit me këto kushtet që janë. Në këtë pikë janë më shumë se një faktor dhe aktor, pra nxënësi nuk është i vetmi në këtë përgjegjësi. Është familja, është shkolla dhe trupa mësimore, dhe më mjaftë rëndësi është faktori shoqëror. Në qoftë se duam të kemi përgatitje të brezit të ardhshëm, në qoftë se duam të kemi zhvillim dhe përparim të vendit, në qoftë se duam të shikojmë se si është vendi shumë vite përpara, mund të shikojmë se si arsimohet brezi i sotëm. Madje japonezët kanë një thënie shumë të bukur: "Në qoftë se do të dish si është atdheu pas 1000 vjetësh, shikon arsimin sot".

Nxënësit kanë shumë mundësi, sot, për të mësuar, por asnjëherë nuk duhet nënvlerësuar mësuesi, shkolla, libri. Të gjitha të tjerat janë ndihmëse të këtyre. Ka hyrë në veprim psikologu në shkollë. Në kohët që jemi është i domosdoshëm, por, për asnjë moment nuk duhet të harrojmë se mësuesi është dhe duhet të jenë gjithmonë një hap përpara në shkollë e kudo në punën mësimore dhe edukative në krahasim me psikologun. Psikologu, në bindjen time, nuk është eprori i drejtorit apo drejtorisë, por as i mësuesve. Ai është mësues për problemet specifike psiko-sociale të punës së shkollës. Vërtetë kryen këtë punë, por gjithmonë në zbatim të detyrave të përcaktuara nga drejtori e drejtorja e shkollës dhe në bashkëpunim me ta. Psikologu duhet të hyjë natyrshëm në jetën e nxënësve, madje nuk më duket e natyrshme as me çua nxënës apo mësues me thirr ndonjë nxënës që ka shfaqje të nevojshme për tu përmirësuar, e aq më tepër me fjalinë "Eja se të kërkohet psikologu". Edhe më prindërit kërkohet punë e kujdesshme nga psikologu. Psikologu është dhe duhet të jenë vendi i besueshëm që nxënësi, por edhe prindi të rrëfehen në mënyrë të plotë dhe të saktë në lidhje me problemet e tyre. Po të mos jenë parasysh këto, mendoj se, nxënësi vihet nën presion, nuk mund të hyhet në botën e tij, e për pasojë, në vend që të vëmë vetulla nxjerrim sytë.

**Luigj Shyti, mësues prej 45 viteve dhe në shumicën e këtyre viteve, prej mbi 30 vjet drejtues, në detyrën e drejtorit të shkollës, në shumë shkolla në Dukagjin dhe në rrethinat e qytetit Shkodër, si në Gurë të Zi, Rragam të Gurit të Zi. Ju, kudo shkollat që keni pasur, ku kanë qenë model. Unë kam parë dy shkolla ku keni qenë drejtor, atë të Gurit të Zi dhe atë të Rragamit të Gurit të Zi te të cilat pashë vërtetë një model të mjedisit jashtë dhe brenda shkollës. Për punën e mirë në**

**shkolla të tjera më kanë thënë kolegët e tu. Kam parë edhe shkolla të tjera, por nuk ka pasur të atillë nivel, që vërtetë mësonin nxënës, por pamja e jashtme dhe e brendshme nuk të jepte përshtypjen, se këta mësues e drejtues janë pa kulturë, me pa përgjegjësi për detyrën që kanë marrë përsipër. Te ju, cili është çelësi i përgjegjshmërisë së paraqitjes të një mjedisi kaq të kulturuar në shkollat ku drejtuat, i cili të jenë dhe një eksperiencë për brezin e ri mësimdhënës dhe drejtues?**

E kam përmendur disi edhe pak më parë. Po, kam punuar vetëm në arsim 45 vjet dhe drejtues rreth 32 vite. Puna dhe arritjet që ju përmendni janë rezultat i punës së kolektivit të shkollave. Unë jam përpjekur që të kem marrëdhënie shumë të mirë me të gjithë kolektivat ku kam punuar edhe si mësues dhe si drejtor. Asnjëherë në shkelje të ligjeve në fuqi, por duke gjetur mënyrën për të realizuar detyrat në kushtet më të mira të mundshme.

Edhe në drejtimin e shkollës, si në çdo punë tjetër, duhet iniciativë, analizë e vendimmarrje sa më të drejtë. Drejtuesi nuk është i duhur që mundohet të përçajë kolektivin, por përkundrazi, vazhdimisht duhet të jenë për formimin e forcimit e frymës së kolektivitetit. Kam punuar në njërin prej shkollave që përmendët ju. Ishte shkollë e madhe, kishte bashkangjitur edhe shkollën 8 vjeçare dhe kopshtin parashkollor, arinin rreth 700 nxënës, dhe kolektivi i mësuesve afër 40 vetë. Kohët ishin të trazuar, më shumë nga politika se sa pamundësia për punë e jetesë. Gjithsekush dëshironte e kërkonte të bënte sipas mendjes së tij, të realizonte tekat e tij. Jo radhë, na shtoj punën edhe futja e hundëve të politikës së ditës, në punën e problemet e shkollës, sidomos në ato që nuk u takonin dhe nuk u takon. Kjo na shtoi punë, që të merreshim edhe me krijimin e mirëkuptimit me drejtuesit vendorë. Bashkëpunimi me nëndrejtorët e shkollës, lidhja me këshillin e mësuesve, bashkësinë e prindërve, me mësuesit me përvojë shkollorë, këshillat e nxënësve, e të tjera bënë të mundur që të krijohej një atmosferë punë e mirëfilltë. Unë kam pasur gjithmonë natyrën, që të mos kem prioritetet urdhrat, por vendosje detyrash e kontroll i tyre, pa bërë dallime e përdorur dy standarde. Po, shembulli personal, ishte dhe duhet të jenë në radhë të parë. Nga ana tjetër, nuk kam synuar që të gjejë mësues të pa përgatitur, duke punuar jo mirë, përkundrazi kam synuar që të gjejë shembuj të mirë dhe ti përgjithësoja. Kjo pati dhe ka efekte të mira, sepse kur vlerësohet njeriu për disa punë, e të tjerat nuk përmenden, kuptohet se ato nuk janë në nivelin që kërkohet. Njerëzit, aq më tepër mësuesi e kupton vetë se ku është e meta.

Pasi jam larguar diku për 5-6 vjet nga një shkollë, takoj një mësues në moshë, me përvojë dhe punëtor i mirë në të gjitha drejtimet. "Drejtor, mu drejtua edhe pse kishim kohë që nuk punonim bashkë, por edhe kishim moshë pothuaj të njëjtë, ai vazhdon të më thërriste drejtor, ti ke dashtë me na bashkua, ndërsa disa të tjerë që erdhën pas tej përpikëshin me na nda nga njëri tjetri".

Unë ruaj mendimin se si janë mësuesit është shkolla, natyrisht gjithmonë në krye duhet të jetë drejtori, ai është figura qendrore e shkollës, në mobilizimin e kolektivit e menaxhimin e shkollës. Kjo është e duhura për një drejtues shkollë, pse jo edhe në fusha të tjera, që më ndihmoj edhe mua në të gjithë punën time kudo ku punova edhe si mësues edhe si drejtues.

Unë kam pasur mendimin dhe vijoj ta

kem se gjithmonë mësuesi më i mirë mund të mos jetë drejtor i mirë. Drejtuesi është menaxher i punës në shkollë, duhet të jenë masovik, energjik. Ai nuk duhet të harrojë se punon me kolegët e tij. Kanë të njëjtën nivel arsimor, ai është njëri prej tyre. Nuk ka dhe nuk duhet të kenë shkollë të posaçme për drejtor, ndërsa trajnime dhe kualifikime po, pa tjetër. Drejtori duhet të jenë i arsyeshëm, mos ta lëshojë fjalën vend e pa vend, të përdorë fyerje, nofka e nënvlerësime, duhet të jenë zbatues i ligjeve dhe vendimeve për të gjithë njëllor, i guximshëm për të pasur edhe mendime ndryshe me eprorët duke i arsyetuar ato, shok i secilit mësues e i të gjithëve bashkë, të qaj e të qeshë me ta, të përpiket me të gjitha mundësitë për të ndihmuar në zgjidhjen e problemeve shoqërore, personale e familjare të vartësit të tij. Kështu, mësuesit, shikojnë te drejtori njeriun që nuk është vetëm për të dhënë detyra e për të kërkuar plotësimin e tyre, por edhe për jetën shoqërore dhe private të mësuesit. Në këto kushte mësuesi është i gatshëm për tu përgjigjur detyrave që i kërkohen. Këto më kanë ndihmuar në punën time në shkolla, kudo që kam punuar, duke formuar mirëkuptimin reciprok, respektin reciprok, gjithnjë në të mirë të punës në shkollë.

Duhet të përmendë se në të gjitha shkollat që punova edhe si mësues i thjeshtë, edhe si drejtor kemi mbetur dashamirë, dhe me të gjithë kemi kënaqësi të dyanshme që të takohemi, të rrimë e bisedojmë bashkë. Kurrë nuk pata probleme për të shënuar në shkollë midis meje dhe mësuesve, mësuesve midis tyre, mësuesve dhe nxënësve, mësuesve dhe prindërve. Kjo nuk është pak, sipas vlerësimit tim.

**Ju keni renditur e falënderuar disa bashkëpunëtor, që ju kanë ndihmuar në punën tuaj hulumtuese, studiuese e shkencore. Mendoj, se me siguri këta bashkëpunëtorë ju kanë lehtësuar në punën tuaj krijuese. Prandaj, në qoftë se mundet të thoni diçka më shumë për rolin e tyre në këtë vepër kaq të madhe?**

Unë i quaj shumë të rëndësishëm bashkëpunëtorët. Sa më shumë bashkëpunëtor që të jenë aq më mirë shkojnë punët. Bashkëpunëtori jep mendimet, të dhënat e veta, ashtu si i di ai. Këtu e ka kryer detyrën bashkëpunëtori. Jo të gjitha materialet që sjellin bashkëpunëtorët mund të gjejnë vend në një botim, ose të botohen ashtu si i ka sjellur ai. Materialet që mblidhen seleksionohen, pastrohen nga "pluhurat", nga lënda e tepërt, ballafaqohen midis tyre dhe pastaj vendosen në vendin e duhur dhe në mënyrën e duhur. Sido që të jenë, të dhënat e bashkëpunëtorëve duhet vlerësuar e falënderuar. Sidomos një libër studimor nuk mund të jenë i plotë pa bashkëpunëtorë në momente të veçanta, pa literaturë referuese, pa të dhëna arkivore, e të tjera.

Sa u takon konsulentëve, sipas mendimit tim, janë një grup jo i madh që njohin përgjithësisht gjendjen, kanë njohuri për zhvillimet në terren dhe dashamirës, koleg dhe shokë me autorin. Konsulentët, kanë qenë dhe janë të rëndësishëm në çdo punë. Edhe të shkruash një libër është e nevojshme që të kesh ndonjë konsulentë. Konsulenti të ndihmon, sinqerisht, për një ose më shumë probleme, në saktësimin e gjerave që janë trajtuar, në gjetjen e vendit të duhur të problemeve që janë renditur në libër, për plotësime e saktësime të nevojshme të datave, ngjarjeve, shifrave. Konsulentët e mijë janë shokë të mijë, të moshës, të profesionit, por janë edhe njerëz që njohin gjendjen e përgjithshme për të cilat flitet në libër dhe

që kanë respekt në bashkësi. Natyrisht konsulenti nuk ka mundësinë, dhe nuk e ka për detyrë, që të kenë në dorë të gjithë materialin bruto për një studim a botim, por merr në dorë kopjen e parafundit. Konsultimi para botimit të krijon mundësi për disa plotësime të nevojshme, konkrete dhe të shpejta, Konsultimi para botimit të jep më shumë siguri edhe në vetë-vete. Unë i kam gjetur, këto, të konsulentët dhe bashkëpunëtorët e mijë, dhe u jam mirënjohës. Ata e meritojnë vendosjen e emrit të tyre në hyrje të librit.

**Luigj i dashur, mbas gjithë kësaj punë të madhe, për të cilën jeni krenar ju, jam krenar unë dhe duhet të jenë secili dukagjinas, secili shqiptar i arsimuar dhe duhet te të falënderojmë, se mbi të gjitha puna për një shekull në fushën e arsimit e të kulturës në zonën e Dukagjinit, tani ndodhet në libër, çka do të dëshiroja, duke shprehur edhe dëshirën tënde, kjo vepër të bëhet me vëllezër të tjerë, cili mund të jenë mesazhi juaj?**

Gjithkush ka dhe duhet të kenë një farë plani, të paktën orientues, natyrisht që mund të mos realizohen të gjitha, por pa një synim, një plan, një angazhim është vështirë që të motivohesh për të bërë një punë, për të shkruar një libër, për të bërë një studim, për të bërë një ndërtim. Edhe unë kam ato planet e mija, që dëshiroj ti realizoj sa më shpejt dhe sa më mirë. Kam përmendur diçka në kopertinën e fundit të librit. Po punoj që ti botoj sa më parë. Po të kem mundësinë e duhur mbase mund të dalë edhe ndonjë tjetër.

**I dashur Ndue!**

Ju falënderoj për vlerësimet, për mënyrën dashamirëse të pyetjeve, dhe për mundësinë që më jepni, dhe nëpërmes këtij bashkëbisedimi të komunikoj me lexuesit e gazetës "Dukagjini".

Pyetjet tuaja, të thella dhe të gjera, më bënë që të jem sa më i hapur dhe kjo më shtyri që të shkruaj disi gjatë.

Dua të theksoj se marrëdhëniet tonë personale e shoqërore janë një shembull i mirë, nga të cilat mund të marrin përvojë edhe të tjerë. Pavarësisht se kemi pasur mendime ndryshe, kemi diskutuar dhe debatuar, natyrisht për asgjë personale, madje edhe në këtë botim, nuk kanë ndikuar në ftohjen tonë, në kthimin e kokës në njërin anë, nuk kanë ndikuar në takimet tona, biseda, shoqëri, kafë e veprimtari të tjera të përbashkëta. Për këtë të falënderoj ngrohtësisht. Sigurisht që marrëdhëniet e mira midis dy personave varën nga të dy, sepse që të dy janë faktor dhe aktor.

\*\*\*

I nderuar Luigj Shyti!

Duke shprehur edhe dëshirën e lexuesit të gazetës "Dukagjini", të falënderojmë për këtë vepër të madhe që na solle, ashtu siç janë të gjitha botimet tua të mëdha dhe me një mesazh mjaft të qartë, për sot dhe të ardhmen, në veçanti me studimin "Dukagjini, rrugëtim në gjenezë" në vitin 2014.

Ju lumtë!

Të urojmë për punë të tjera hulumtuese, studiuese e botuese dhe me mesazhe të qarta, si vazhdimisht, për sot dhe për të ardhmen!

*Bashkëbiseduesi,*  
**NDUE SANAJ,**

*Shkodër, 17 korrik 2019*

# “MONOLOG ME VETEN”

MBRESA NGA LIBRI “MONOLOG ME VETEN” (KUR NUK KAM NJË PARTNERE PËR TË BISEDUAR) TË AUTORIT MERITAN SPAHIJA



Nga Suela Ndoja

Është një kënaqësi për mua që pata rastin të lexoj e të rilexoj librin "Monolog me veten - Kur nuk kam një partnere për të biseduar" të autorit Meritan Spahija. Autorin e nderuar pata fatin ta njoh gjatë punës në gazetën e përmuajshme "Dukagjini", ku tashmë është një mik i përbashkët.

Në mes të shumë librave të tjerë, që ishin në Shtëpinë e shtypshkronjës "Fiorentina", më tërhoqi vëmendjen titulli i librit "Monolog me veten - Kur nuk kam një partnere për të biseduar". Kjo ngaqë në vetvete monologu është një mjet për të shprehur mendime dhe emocione të një personazhi fiksional që shpesh është vetë protagonist. Mirëpo siç thotë novelist Henry Graham Greene "çdo monolog herët a vonë bëhet një diskutim", diskutim ky që më la mbresa dhe më motivoi të analizoj librin në mënyrë modeste nga këndvështrimi psiko-socio-artistik.

Në një këndvështrim të përgjithshëm vihet në dukje që autori ka respektuar rregullat bazike të të shkruarit të një monologu me veten duke u përpjekur që të mbajë një linjë të pasur figurative, por edhe të thjeshtë dhe të kuptueshme për lexuesin, i cili lexon e jo atë që vetëm shfleton faqet. **Stili transparent, por edhe i ndërthurur i të shkruarit** të shpie drejt pikëpamjes për librin si prodhim i veçantë artistik me funksion psiko-socio-artistik; **teknikat e rrëfimit dhe përshkrimit**, që përdor autori synojnë formën modeste dhe mistike njëkohësisht të paraqitjes pasi aty detajohen portretet fizike dhe sociale, ambientet e të tjera në funksion të përgjithësimin dhe specifikës gjithashtu.

Autori e ka përcaktuar perspektivën e monologut me veten duke e ndarë në gjashtë kapituj (Përsiatje, Përkushtime, Nostalgji verore, Rrëfime, Çështje nderi & Jazoni) nëpër të cilët janë renditur nënpjesët e kategorizuara. Në secilën prej pjesëve autori paraqet një llogari telegrafike të mendimeve dhe ndjenjave që kalojnë në mendjen dhe zemrën e personazhit. Gjithashtu, autori ka theksuar zërin e monologut të brendshëm, me idenë që zëri të përfshijë pjesëza superiore & inferiore në të cilën edhe lexuesi si pjesë

e publikut ta gjejë veten në së paku njërën prej tyre si vete fizike apo sociale.

Në hapin vijues, i jep një kuptim monologut duke theksuar synimin: për ti dhënë personazhit një pozicion të shprehuri, për tu parë ose së paku për t'iu dëgjuar historia, sekretit ose një përgjigje ndaj një pyetjeje ose një çlirimi emocional. Ky lloj monologu me veten, megjithatë shton tensione, ose emocione për lexuesin duke krijuar gjallëri, ose insajti të ri në çështjen ekzistuese. Kjo është një pjesë madhore pasi nxit një prekje afektive nga personazhi tek lexuesi.

E rëndësishme është se autori e ka përcaktuar, se kujt i adresohet monologu, pra vetes, gjë e cila e lehtëson strukturën e monologut të brendshëm, për ti treguar lexuesit ndjenjat ose mendimet e tija. Përveç aspekteve strukturore, *Libri* është i rëndësishëm për mënyrat, nëpër të cilat lidh së bashku stilin klasik të të shkruarit letrar me ndërthurje psikologjike.

Gjithashtu është e dukshme, që autori e ka përcaktuar fillimin, mesin dhe fundin e një monologu në të cilat përfshihen aspekte të ndryshme jetësore si kujtime, nostalgji, rinia e hershme e autorit, konceptime të ngjarjeve me karakter social, konotacione filozofike, mite dhe zakone, imagjinatë, ndërthurje me një realitet aktual dhe vetëdije kulturore të autorit.

Të shkruarit e një monologu me veten kërkon experience, të cilën autori e shpalos me shumë mjeshtëri. Interesante është përpjekja për të vozitur përmes monologjeve tridimensionale: *monologu dramatik* në të cilën paraqet një përgjigje të shtrirë në një dialog si psh tek pjesëzat: Ne djemtë e lumit, Rituale plazhi, Perseu, Dilema e Tezeut, Jazoni; *monologu solo*, në të cilën autori i drejtohet audiencës, për të cilën personazhi flet duke drejtuar mendimet dhe ndjenjat e tij. Ky aspekt e bën këtë monolog më artistik dhe dramatik. Në këtë rast mendoni për "Të jesh apo jo të jesh" i Shekspir. Të tilla mund të gjejmë si tek "Ndërsa bën sikur lexon", "Ora 7.30" e të tjera; *monologu i brendshëm*: ky lloj ndodh posaçërisht vetëm në letërsi ku autori përshkruan mendimet dhe ndjenjat e tij përmes një monologu jo të folur. Të tilla monologje gjenden në pjesën më të konsiderueshme të librit.

Tashmë do të qendërojmë kornizën duke e sjellë më afër brendësinë e librit.

Që nga titulli, autori ka përdorur një ganxhë të bukur për ta mbërthyer lexuesin në jo vetëm të lexuarit e librit, por pikërisht në mbajtjen e vëmendjes së tij duke mos e mërzhitur lexuesin që në fillim apo gjatë momenteve të ndryshme të të lexuarit.

Autori ka krijuar një rrjedhë të natyrshme, por edhe mistike duke zbatuar

aspekte të ndryshme të një monologu si toni i duhur në pjesëzat e dhëna, sjellja dhe gjuha e paraqitjes së çështjeve në libër. Në këtë mënyrë përfshin njohjen më të mirë të personazhit dhe në të ndërtuarit të zërit të tij dhe gjuhës artistike të dalluar dhe unike nëpërmjet prozave që paraqet. Personazhi, duke u bërë kryesor, mban çështjen dhe tonin që kërkon të shprehë



dhe ti transmetojë lexuesit.

Nëpërmjet pjesëzave të dhëna, autori ka përshkruar një reflektim gjithë përfshirës (të së kaluarës, e cila përsiatet edhe në të tashmen me një perspective ndryshe për të ardhmen). Ngjarjet e kaluara dhe të tashme gjithmonë kanë një lidhje të paevitueshme, për të arritur një balancë mbi reflektimin në monolog. Përshkrimi i miteve të hershme e kanë iluminimin në detaje të veprimeve aktuale, sepse bëhet fjalë për kujtesën e personazhit që i adresohet çështjeve, që vijojnë të dominojnë në shoqërinë e sotme të tilla si bukuria, sipërfaqësia, mençuria e padituria, klima familjare, marrëdhëniet ndërpersonale, paradigmat e trashëguara, feminiteti, maskuliteti e të tjera.

Ndërsa zëri poetik i autorit është ndikuar ndër të tjera nga eksperiencia e tij si një burrë me tradita shkodrane, ai përpiket njëkohësisht të nxjerrë në dukje të vërtetat universale humane, që mbretërojnë nën hijen e pavetëdijes kolektive. Psh tek "Përsosmëria" autori shprehet: "përsosmëria jo rastësisht formën e rrethit", gjejmë Fjalët e thërrimeve (një shprehje, që një folës përdor vijimisht, që nuk shton kuptim për ato që janë thënë; zakonisht përdoren, kur një folës po kërkon një mendim ose vendos, se si të shprehë siç duhet atë që mundohet të thotë). Për ti shtuar edhe vërtetësi librit të tij, autori pra e merr zërin edhe nga realiteti aktual. Në duart e autorëve të tjerë ndoshta kjo premisë mund të ndërtonte kryesisht

imazhe artistike, por në duart e vetë autorit peshon edhe seriozitet dhe madje shqetësues sepse në lëndën e tij poetike reagon, reflekton në të ndërgjegjshmen e tij të thellë.

Në eksplorimin e tematikave si aparenca, esenca, e vërteta dhe të kërkuarit imagjinar, autori e gjen veten si një meditues, që reagon ndaj çdo gjëje që dikush thotë ose bën si dhe ndaj një personi që është duke folur pasqyron, që qëllimi i vetëm i atyre fjalëve është ta njoftojë folësin që ende dikush e dëgjon ose pranon në mënyrë pasive për ato që thotë.

*Në mbyllje*, mund të them se autori vjen me një paketë të mbushur me momente të paparashikueshme, ndershmëri brutale, shpërthime emocionale, nevoja të kobshme për dashuri, nevoja për të vënë në dyshim gjithçka, përzemësi të përzier, dashamirësi tensionuese, shpirtërore të pavendosura, bukuri të pahijshme, krijimtari të thellë, hobe të fshehura, pasion përçmues, traumat e fëmijërisë, një përkujdesje e bezdisshme, ndjeshmëri ironike, humor të qortueshëm, sarkazëm, ndjenja të pakënaqshme, vetëbesim të pakalueshëm, dhembshuri,

frymëzim dhe një zgjuarsia artistike e veshur me një temperament flegmatik. Autori tregohet mjaft grotesk në vetëdijen e lartë dhe nënvetëdijen e ndërmjetme duke i shfaqur natyrshëm.

Ky libër krahas të tjerave përbën për lexuesin një urë introspeksioni (procesi i reflektimit joformal) dhe ndër të tjera vetvetiu shndërrohet në kuptim të gjerë psiko-social së skenës së madhe njerëzore. (Shprehur më qartazi, procesi i reflektimit joformal ka të bëjë me të shqyrtuarit e mendimeve dhe ndjenjave të brendshme të një personi dhe duke reflektuar në atë që ata thonë bazuar në përvojën aktuale mendore të një personi ose përvojat mendore nga e kaluara e fundit).

*Duke e falenderuar përzemërsisht autorin*, për këtë libër kaq të rëndësishëm dhe me vlerë, **mesazhi që do të sugjeroja të marrim me vete** do të ishte: Edhe pse monologët janë me zë të vetëm, në paraqitjen e tyre artistike kanë nevojë për një realitet më dialogor, me një "dëgjues" të vërtetë ose imagjinar, të cilit i drejtohet monologu. Si të tillë, ju takon juve të gjeni produktin e monologut me veten, nga se është formësuar dhe përpunuar, sepse është rrugëtimi juaj, ju jeni udhëtar dhe zëri juaj i brendshëm thjesht ju shoqëron në të gjitha distancat me veten, me të tjerët dhe me mjedisin që ju rrethon. Më pas ju mund të skiconi lehtësisht hartën empatike që përfaqëson aspekte të ndryshme të vetes lidhur me atë që shihni, bëni, mendoni dhe ndjeni në jetën e përditshme siç ka vepruar autori i nderuar.



# TRADITA E MARRJES SË FLOKËVE

(RRUARJA E FAMUJVE)

Marrja e flokëve (prerja dhe rruarja) nga kumbara ka qenë një ngjarje e shënuar në jetën e familjes dhe të fëmijës në veçanti. Mbas fëmija mbushte tre vjet gjithmonë në stinën e dimrit, para motit të lidhur (i cili ndryshonte sipas kalendarit hënor, por gjithmonë pjesërisht i bije gjatë një pjese të Janarit dhe shkurtit) i merreshin flokët nga kumbara. Me këtë rast në shtëpinë famullit bëhej një ceremoni e veçantë festive.

Babai ose gjyshi i fëmijëve (thirrësi) shkonte disa kohë përpara tek kumbara për fiksuar datën marrjen e flokëve dhe i thoshte: - Kumbara, kam ardh me të pevetë kur ke mundësi me ja marrë flokët najti famulli (ose famulleshë) pasi qetash i ka mbushë 3 vjet? Kumbara përgjigjej - "Famulli kjoftë jetë gjatë! Me shëndet e me të mira i kjoftë marraja e flokëve!" Sa për mundësitë e mija mos ki dert as një fije, moti nuk është i lidhun, hana është re (shikohet faza e mbushjes që flokët t'i rriteshin dhe fëmija të jentonte sa më shumë), prandaj kur ta kesh qitë cikën unë jam gati: Gjyshi ose baba i fëmijës ia kthente urimin: "Kjosh jetë gjatë more kumbarë, ruash famuj e famullesha, të pastë shtëpia, ndrikullat dhe probatinat!"

Thirrësi pastaj hante mesditë të shpija e kumbarës duke biseduar lirshëm deri në detaje për gjera për punët dhe problemet e dy familjeve shumë të hapura dashamirëse.

Thirrësi i drejtohej kumbarës: Pash Krishtin sa për kursim temin mos e leni pa ardh gjithkush të keni qejf, i madh e i vogël!

Merr me veti ka të dush edhe tek kushërirë nga 1 ose 2 për shpi. -Nuk më ba nderën, po më kurseve! Famuj nuk rruhej për ditë. Unë një djalë të kam, kumbarën e kam t të zgjedhur me kokërr, prandaj nuk na ka hije mua as ty me po nuk e bamë një fije poterë gëzimi. Paç faqen e bardhë e gjithmonë për të mira e gëzime u bashkofshim tek shoqi-shoqi!

Ti fole burrisht si burrë si je. Mue me rrue famijt te shpija jote nuk më shkon mëndja me ardh mëshehtas. Pasha kumbarinë një patërxhan i joti (domate) me të shkue dam kot më dhimbet, por nuk më dhimbet as një fije harxhimi, kur bahet për nderë e burri!

- O ju dhimbsh Zotit morë kumbar, mbyllte bisedën tjetri dhe fiksohej përfundimisht data e konakut. Ditën e orokut, kumbara shkonte së bashku me gruan dhe 3-5 veta nga familja e vet dhe nga një tot shtëpie të kushërinisë së vet, duke e çuar kuotën e vizitorëve nga 8-10 persona.

Në konakun e djalit, ati i fëmijës, ftonedhe edhe nga një tot shtëpie, të lagjes vet,

prandaj në raste të tilla bëheshin 2-3 st-revesa të ftuar.

Kumbara shkonte në darkë, atij i dilini përpara një copë rrugë përtej shtegut të oborrit, dhe i uronin mirëseardhjen me gjithë shokë.

Kreu e vendit i takonte gjithmonë kumbarës me përjashtim të rasteve kur ai ja dhuronte ndonjë burri më të vjetër nga lagja e tij.



Sa hynin brenda në kullë, gjenin zjarin duke vërshllue flaka në oxhak, zinin vendet pëveteshin, dridhnin duhan, pastaj hynte xhezja në oxhak, piqeshin kafet e moçme dhe filxhanat u shpërdaheshin me takabe gjithë të ftuarve. Kur të gjithëve u shakonin kafet përpara, i zoti shtëpisë merrte ibrikun dhe i thoshte fjalët sips adetit.

"E pifshim me nderë!"

-Kjosh me nderë! ia kthenin të ftuarit.

-Kjoftë Lëvdue Jezu Krishti - Gjithmonë e jetës!

Mirë se u pruni zoti!-Mirë se të gjetëm!

Kumbaria na kjoftë për hajër! -Paç hajr e faqën e bardhë!

Kumbarë kjosh jetë gjatë! - Lumte goja, ma paç faqen e bardhë, me jetë gjatë famujt e famulleshat.

Zoti i baftë hise mëdhenj!

Edhe kur kthehej tervesa, kështu vazhdonte refereni i urimeve të ndërsjellta.

Rakia qitej me ibrik e pihej me gota të vogla me kodra, trevesa mbushej gomilë me djathë mushkëri, turshi, qepë hudra, specia, sita e petullave dhe bluda e

mjalëtës shkonin krah për krah, thalbët e arrave, ftojt ose mollët, pse jo edhe rrush të ruajtur kastile, pa harruar asnjëherë as kosin i kulluar.

Kuvendi rrafshit, kanga e lahuta, fyelli, çiftelia e shpotitjet, të shtimet e pushkëve dhe aventurat gazmore nuk kishin inventar atë natë.

Pas 2,5-3orësh hiqej rakia dhe vinte buka e kakinit me afshin e saj të ngrohtë e provokuse, e cila së bashku me djathin formonin një duet, që bënte këdo për vete.

Burra rakinë e hoqët shpejt, se deshët me ma kursye, i qortonte i zoti i shtëpisë të ftuarit.

Pashë Zotin hani bukë e djathë e mos na bani për fjalësh!

Gjithmonë gati me një tas okatar të madh në dorë qëndronte një shpiak e u shpërnda ujë të pranishmeve.

Djathi i premë nuk kthehej ashtu siç kurrë nuk lejohet të pritej i gjithë në tervesë pa e lënë një të preme të pa prekun.

Pas djathit vinte bluda më lag e droçka vjamit, në këtë lang zbuteshin përsheshët (në kohërat më të vonshme përsheshin e zevëndesuan me pilafin), bluda duhej lirue dhe vinte tjetra deng mbushur me tureçka mishi. Mish i shoqërohej me venë. Në rastet kur piqej ferlig, nuk aplikoheshin as përsheshët e as pilafi. Vena vijonte edhe pasi çohet tervesa deri vonë sa mbaronte loja e kapuçave.

Famulleshës flokët i merreshin në darkë, kurse famullit, gjithmonë në mëngjes dhe me hanë të re, pasi pihej kafe e raki nga të gjithë të pranishmit.

Ceremonia e marrjes së flokëve bëhej në prani të gjithë të ftuarve. Famulli vihej në prehrin e nënës, rreth qafës i lidhej një shami, siç bëhet tek berberi. Kumbara e përqaftonte famullin, pastaj fillonte qethejen flokëve, të cilët bashkoheshin në shami, shamia mblidhej e vendosej jashtë dhomës.

Kumbara pasi e qethte zero famullin, merrte sapun rroje dhe furçën dhe i shkumbonte kokën mirë e mirë dhe me pas rrues, e rruante dhe e bënte trurtullak.

"Me shëndet famull! Kjosh jetë gjatë!" - ishte urimi i përzemërt i kumbarës.

"Paç shëndet, të lumtë dora kumbarë!" - përgjigjet baba i djalit.

"Kjosh jetë gjatë ti e famulli!" - uronin të ftuarit e tjerë.

Kumbara i vinte kapuçin në krye famullit, që ishte dhuratë nga gruaja e kumbarës. Pastaj dilte jashtë dhomës merrte

shaminë e flokëve dhe në flokë lëshonte një sasi të caktuar parash. Sasia e lekëve të lëshuar nuk publikohej, shaminë e merrte ndrikulla dhe e vendoste diku sipër derës dhe vetëm pasi ikte kumbara e hapte dhe shihte sa pare ka lanë.

Paret ishin të famullit dhe i merrte ndrikulla në zotërim. Një sasi flokësh ruheshin të mbështjellur në një cep shemie për shumë vite, diku në qoshen e arkës së rrobave të ndrikullës.

Pasi rruhej famulli, bëheshin një ose dy vizita në shtëpinë e kushërive ose komshive të famullit. Gjatë vizitave pihej kafe, raki, meze, pastaj burrat dilnin e gjuanin shenja, ku mund të vinin edhe njerëz të pa ftuar (ndonjë qitës të pasionuar), të cilët i zoti i shtëpisë i mbante për drekë.

Pas garës, të ftuarit ktheheshin përsëri në tervesë dhe aty u serviroshin, ushqimet më të mira. Sa po fillonte rakia dhe bëheshin urimet e zakonshme nga secili i ftuar, kumbara nxirrte kuletën dhe fillonte faljen në të holla: së pari, falej ndrikulla, kuptohej deri sa kjo gjë bëhej publike, sasia e pareve ishte e konsiderueshme në vartësi të parës së çdo kohe. Pas ndrikullës, faleshin motrat e sajë, gjyshëja e famullit dhe të gjitha femrat e shtëpisë:

"Kumbarë të rritë Zoti nderën e xhepin! Pasha bukën po më dhimbesh për shpenzimin, i paske ra rand he burrë!" - i thoshte i zoti i shtëpisë.

"Kjosh me nderë e më të mira! Nuk jam shpenzue veç as me thanë se më ka ra ndermen!" - ja kthente kumbara.

Natyrshëm, festa vijonte me gjithë intensitetin e vet. Pas dreket, pinin edhe nga një cigare duhani dhe të ftuarit largoheshin shumë miqësisht me urime dhe komplimente të ndërsjellta.

Para se të largoheshin ndrikulla, nëna e famullit dilte në qoshe të oborrit, të ftuarve u jepte peshqeshe nga një palë çorapë me shputë të qëndisur me shkrojlja, shami ose peshqirë shpesh herë edhe nga një palë duhani.

Ndrikulla duhej që t' kthente vizitën kumbarës së bashku me famullin, prandaj shkonte së bashku me të ftuarit.

Ndrikulla tek kumbara rrite 3-5 net, por jo më pak se tre net.

Ndrikulla përgatiste posaçërisht për kumbarën, këmishë të bardhë të qepur me pala, çorapë të thurur bojëra (ngjyra) të ndezura, shokë dhe shall të bërë vetë në vek, kapuç deveje dhe opagë të kuqe me lëkurë safjani.

Ndrikulla u sillte dhurata edhe grave dhe vajzave të shtëpisë (shami, sapun), fëmijëve çorape, fruta dhe ndonjë gjë të ëmbël e të tjera.

Siç shihet shpenzimet për të dy palët kanë qenë të kripura dhe po të kemi parasysh një burrë më shenj, besnik dhe shtëpi e mirë, i cili mund të kishte disa ndrikulla (5-6 apo apo 7-8), kuptohet sa të vështirë e kishte të bënte gjithë këtë mori shpenzimesh të detyrueshme.

# I VETMUARI I MADH, FREDERIK RESHPJA

Nga **Bedri Islami**

Rrallë Shqipëria ka pasur një poet të tillë, me fatin e tij të çuditshëm dhe tragjik; rebel në gen dhe paqtues në shpirt; i rënë në humnerë nga shpirti i tij dhe i ngritur në qiell përkohësisht, për të rënë edhe një herë në humnerën e tij, kësaj here përfundimisht; mjeshtër i fjalës dhe arrakat i pandreqshëm; i adhuruar dhe i mallkuar në të njëjtën kohë; me kokën e shkërleshur si një demon Lermontovian dhe i gatshëm për të qenë një duelist i kohës së shkuar; i butë si një fëmijë i rënë në prehrin e nënës dhe diellor në fjalët për miqtë.

Kam qenë tepër i ri kur e kam takuar për herë të parë dhe, së bashku me poetin e ndjerë Tonin Shtjefni, na ftoi në shtëpinë e tij, në njërën nga kthesat e para të rrugicës së Gjuhadorit, njëra nga më të vjetrat e qytetit të Shkodrës, gjysmë përdhese, me oborrin e vogël, mbushur me lule, ku trëndafilat ishin të harlisur dhe për të cilat kujdesej nëna e Frederikut, me të njëjtin mall si edhe për të birin rebel, të shkujdesur, që aso kohe ishte mësues dhe që e dinte vetëm ai dhe zemra e saj se ky ishte vetëm një çast i prehjes.

Në dhomën e vogël të tij, me dritaret e rrethuar nga ornamentet e hekurt, ishte rrëmuja e një poeti që sapo kishte nisur për botim librin e tij të parë poetik, "Rapodi shqiptare".

Tek ai, çuditshëm, të dyfishohej dhimbja, e befas, të krijohej iluzioni i qetësisë së përkohshme, trishtimi i jepte ngjyrë, ndërsa drita pluskuese e mëngjesit mund të ishte vetëm një dalje nga shpirti i tij.

Shpesh herë, si i kthyer nga një kohë tjetër, fliste me fjalë të mëdha, përmende gjuhët e shumta që dinte...e në fakt aso kohe fliste vetëm shqipen e tij të mrekulueshme, plot alegori, dritë, netë të brishta dhe shpirt kopshtor; të tregonte për dashuritë e tij të mbetura buzë gremine dhe nuk e dinim nëse kishte diçka të vërtetë në këtë ëndërr rrjedhëse dashurore.

Ai ishte dhe mbeti deri në fund një mikpritës besnik. Për miqtë e tij, shumë nga të cilët e tradhtuan, i dolën dëshmitarë të rremë, e përgjuan, e shanë, e flakën, e trajtuan si një të huaj, të padenjë për qytetin e lindjes, kur ishte një vazhdim i Migjenit, i cili kishte jetuar në po atë lagje, vetëm në kahun e kundërt të saj, ai, edhe kur u përmbyesën kohët dhe figura e tij tani mund të ishte mitike, mbeti një portë e hapur.

Në fakt, nuk mund të ishte ndryshe. Ai mbeti, në vetveten e tij, një kristian idealist, por edhe një përjetues i dhimbjes njerëzore dhe, duke e ditur se trasnia kishte qenë më e fortë në disa nga miqtë e tij se sa dëshira për të qëndruar, i falte.

Në pas vitin 1990, kur ai tani mund të ecte i qetë rrugëve të qytetit, pra, të kalonte nga rrugicat në mbrëmje apo netëve të heshtura, kur nuk donte të rën-

donte askënd me takimet e tij, në mesin e Piacës, kishte mjaft njerëz që i shmangeshin, tashmë nga ndjenja e fajit.

Në njërën nga këto ditë ne ecnim në rrugën kryesore, dhe pastaj, ashtu si ecte ai, me duar të hapura që i lëvizte rrëmujshëm, kaluam para Kafes së Madhe, në sheshin para së cilës, ishin ulur shumë njerëz, duke e shijuar pranverën.

Befas, krejt afër, atij i zuri syri njërin nga denoncuesit e tij, gazetar dhe botues, i cili, ndoshta me të njëjtin kostum që kishte veshur solemnisht kur kishte vajtur për të shpallur dëshminë e tij, po rrinte dhe bisedonte gjallërisht.

Frederiku e pa dhe u ndal. Tjetri ndali fjalën, uli kokën, do të kishte dashur të zhdukej në atë çast, në buzë i ngriu fjala që kishte dashur të thoshte, shpupurishi flokët e shumtë, si do të donte të krijonte

kam harruar apo jam i gabuar. Ti, mos e harro të keqen dhe përmendu, se burrat përmenden!

Mbeti deri në fund me shpirt kristian të padukur dhe askush, ose më saktë, pak kush, mendoj për shpirtin e tij.

I habitshëm dhe ndryshe nga gjithçka. Ashtu i kishte edhe ditët e fundit. U largua si ato drerët e plagosur që mbajnë në brirët e tyre dritën e hënës, me mallin për nënën dhe vetminë e tij legjendare.

Nga bota e shkrimtarëve ishin në largimin e tij të fundit pak vetë, Skënder Drini, Moikom Zeqo dhe Arben Billaci. Më tej Myftar Gjana, Shpëtim Kelmendi, Ledia Dushi, Fatime Kulli, dy pedagogë të letërsisë, Hasan Lekaj dhe Alfred Çapaliku... dukej sikur qyteti e kishte harruar, ndërsa mburrej me të.

Të tjerët, duke e pranuar heshtjen e tij


modernë më të mëdhenj të Veriut të Shqipërisë, të qytetit magjik, Shkodrës, së bashku me Ndre Mjedën dhe Migjenin. Ndërkohë është poeti më tragjik i letërsisë shqipe. Tragjik nga jeta e tij vetmitare dhe e plasarit nga mungesat e mallit; tragjik nga ndalesat që i janë bërë përmes burgimeve në monizëm dhe "harresës" të shtetin plural; tragjik nga miqtë që e tradhtuan në një çast; tragjik edhe në vdekjen e tij vetmitare.

I vetmuar deri në skajim, me një fëmijëri të harruar, pa rini – sepse ia morën, moshë të bardhë të zezuar, ai më pas do të shkruante se:

*Pashë fëmijët në rrugë. Të qeshur, / Të bukur dhe delikatë si vazot e çmuara / Ku nënat fshehin ëndrrat e tyre.*

*Më panë dhe u trishtuan. Menduan, / Që unë nuk kam qenë kurrë fëmijë*

Vetmia e tij tragjike do të ishte përndjekja e shpirtit dimëror të tij, që binte pikë – pikë, një këtu – një aty, si trëndafilat e vdekur, në një muzg të ngjyer me ajër, nën shirat e heshtur të qytetit të vjetër. E ka ndjerë këtë vetmi edhe pas viteve të burgimeve të tij, pikërisht atëherë kur mendohej se tashmë do të kishte një tjetër përsiatje, më të furishme, të denjë për karakterin e tij rebel, por, si në legjendat e lashta, do të ishte pikërisht



një perde.

Frederiku i thirri në emër.

Ai ngriti kokën dhe shikoi me ankth.

-Përse nuk më flet?-i tha Frederiku. Përse? Të mos të të flas unë, kjo kuptohet, por të mos më flasësh ti...?

Tjetri kishte mbetur si shtatore e ngrirë dhe vetëm pak, në njërin cep të buzës, buzëqeshi duke ngrirë.

-Unë e kam harruar atë që më ke bërë ti dhe nuk e di nëse kam bërë mirë që e

si një falje, nuk kishin guximin të shkolin dhe t'i kërkonin faljen e tyre njeriut shpirtmadh, që, gjithë jetën kishte qenë në mjerimin e harresës e tij.

Nga doli kjo vetmi kështu...nuk kishte për ta parë më këtë qytet me rruginat e vjetra, as kështjellën e ngritur mbi sytë e një gruaje, as të gjallët e as të vdekurit.

\*\*\*

Frederik Reshpja është një ndër poetët

kjo ndjenjë rebele që do e ripërsëriste vetminë e tij.

*Lulëzoi druri i portës së vjetër / Ah! Druri i vdekur çeli lule! / Ti këputi dhe me to bëj kurorë*

*Për mua që të prita deri në vdekje!*

"Sidoqoftë ky mëngjes do të më vdesë ndër duar...", megjithëse dukej se trëndafilat çelën që në mëngjes, me petalet në ngjyrën e vetëtimës, e përsëri, ai e di , fare mirë e di

se "trëndafilat vetëtimë në heshtje për gjëmën time", e di se , edhe një herë, kështu e ka zënë nata, si statujat e pritjes, në një ajër që vdes dalëngadalë dhe dimëron,...ku në peizazhin e natës, si në një ëndërr, zhduken drurët me fjalë e me gjethe dhe luleve u rrëzohen ngjyrat...

Vetmia e tij ishte elegjike...askush nuk e zhbëri dot atë...ai mbeti nën dimrin e kësaj vetmie të madhe ...duke na sjellë poezinë e tij si një stinë e re që bie nga qiejt te xhamat e dritares së vjetër, të së dashurës botës sonë...

Në fakt, ai nuk mund të ikte ndryshe, veçse si një vetmitar, duke na lënë pas pezmin e trishtimit dhe ndjenjën e fajit të pashoq për braktisjen e tij.

Vetmia e tij ka qenë e një përmase gati biblike, ashtu si kanë qenë edhe tradhtitë ndaj tij. I ngritur në majën e Olimpikut poetik për një çast të shkurtër, do e ndjente theqafjen , vërvitur nga miqtë.

\*\*\*

-Fred, ku vete kështu? – më pyeti dikush që po hante.

-Po shkoj të gozhdohem në kryqin tim.

Ky qe njeriu që më bëri gjëmën...Do të doja më mirë të më priste në fyt. Unë i kam provuar prerjet: ato nuk të dhembnin sa tradhtia e një mikut. Mua më shumë më kanë tradhtuar se më kanë prerë.

Pra, armiqtë më të pamëshirshëm për mua, kanë qenë miqtë. Lavdi Zotit, tani nuk kam asnjë mik.

\*\*\*

Askush ai nuk është ngjitur në Golgotën e pazakontë të një jete që ndërpritej nga burgimet dhe që duhej të niste nga e para.

Kokëshkretë, mohues dhe pohues njëkohësisht, mik i madh dhe i tradhtuar marrëzisht, i heshtur dhe fjalë shumë në një çast tjetër; modest i pakërkundtë dhe pak më vonë një mburravec i padëmshëm, i thyer nga poezia që i rëndonte në shpirt, por i pathyer nga mrekullia që i bulonte në peizat e shpirtit të tij; mistik dhe i hapur; adhures i Zotit dhe mohues i tij; mbi të gjitha ai do të ishte poeti që kishte një idhull të vetëm dhe një shenjtorë të vetme: Nënë e tij.

Kryefigura e tij qe nëna. Nëna e Frederikut, të cilën e kam njohur që në rininë e hershme, qe një grua me një qëndrim dinjitoz, krenare dhe shumë autoritare. Fliste pak, qëmtonte fjalët e mira, por ishte e repretë dhe sunduese mbi fëmijët e saj.

\*\*\*

Frederiku, si kujton miku i tij më i afërt, Moikom Zeqo, mund të zihet me të gjithë, nuk bindej, madje edhe mund të shante gjithçka, por në praninë e nënës ai qe një genie gati engjëjlore.

Të gjithë, a thuajse të gjithë, e braktisën poetin, nëna nuk e bëri kurrë. Të gjithë mund t'i kishte harruar poeti, por nënën e tij kurrë.

Ai që nuk i binte ndër këmbë pushtetit, puthte këmbët e nënës së tij; poeti që nuk i kishte lëvizur qepallat në netët e gjata të hetuesisë dhe pyetjet absurde e kishin bërë të nënqeshte, çka ishte shoqëruar me mallkime të tjera dhe hetuesi torturues, përloj nga vuajtjet e nënës së tij.

Shpesh herë ai kishte menduar largimin nga jeta, qoftë edhe si heshtje e

mëvetishme, por kurrë nuk i ishte afruar asaj: për deri sa ishte nëna. Në rrugicën e ngushtë drejt shtëpisë së tij, në oborrin e së cilës gjeje gjithnjë trëndafila, Frederiku shpejtonte hapat...e priste nëna. I pakujdesshëm në pamjen e tij, ai në fakt ishte i shëmtuari i bukur, aq më tepër i pakujdesshëm në ditët e burgimit të tij, ai, dy ditë para takimit me nënën, që vinte nga larg krrisur mbi vitet dhe hallet, filloje të zbukurohej...të bëhej Frederiku i gjithëditshëm dhe i dritshëm.

Dy nga librat e tij më të shkëlqyer, që më mirë se gjithçka sjellin vetminë e tij të madhe, mbuluar nën dëborën e moteve dhe ftohtësinë e kohës, ai do ia kushtojë nënës së tij, duke bërë dedikimin "Nënë sime, e cila ka vuajtur shumë pas meje nëpër burgje, internime e spitale. Me dhembshuri, Frederik Reshpja".

Poezitë e Frederik Reshpjes për Nënë e tij janë tronditëse, të mrekulluara nga ndjenja e një fluiditeti madhor, që duket sikur nuk është e tashme, por e ardhur që nga malli i Ajkunave për bijtë dhe, më tej akoma, që nga dëshira e Rozafës për birin e saj...një dorë jashtë për ta përkëdhelur...një sy jashtë për ta parë...një gjoks jashtë për t'i dhënë qumështin e saj...që ende rrjedh në muret e kështjellës së vjetër.

*Iku dhe nëna ime nën një shi prej mermeri / Nga arkeologjia e perëndive që rrëzoheshin. / Ave, nëna ime! / Vetëm tek ti kam besuar, / Zot tjetër nuk kam pasur kurrë, Amen!*

*Më tej... / Eja me mua në kopsht: / Tani që dimri iku dhe tërë dëborërat kanë rënë / Nga drurët zbrasin ca statuja ajri / Dhe çelin sytë e luleve që flenë.*

*Por tani që nëna nuk është / Hapen dyert e hijeve e dalin perënditë ilire / Me tunikat e prera nga mjegullat e lashta / E trëndafilat janë mbyllur në pikëllimin e vet*

*Eja të dalim në kopsht, / Por nëna nuk është më!*

*Më tej / Ah, ku ke rënë kështu, ku je tretur! / Nënë, nënë! Do të vinë dëborërat, / Do të bien mbi barin që ka mbirë nga zëri yt...*

"Ca zogj të zinj vraponin në ajër si të trembur nga një dimër që rend. Më erdhi keq për zogjtë. Befas m'u shpik një frikë e tmerrshme: nëna!

Ajo kishte nevojë për kujdesje të vazhdueshme. Flinte. E bukur, pakëz e zbehtë, me flokët e zinj dhe të gjatë të hedhur mënjane.

Oh, nënë, nëqoftëse ti ikën tek yjet, nuk e di se ç' do të bëj më në këtë botë!

Nuk do të kalonin shumë kohë dhe unë do të puthja buzë varrit duart e njeriut që kam dashur si Zotin!

\*\*\*

Unë e mbaj mend mirë oborrin e vogël në shtëpinë e Frederikut mbushur me trëndafila. Të shumëngjyrshëm dhe të kudoshëm. Që nga parvazet e dritareve të ulta, në skajimin e murit të gurtë, në rruginat mes kopshtit, pranë portës së hyrjes, mbi muret – harlisur nga stinët. Si rrallë poeti ai i ka trëndafilat pjesë të poezisë së tij. Ndoshta edhe ata hynin në atë pjesë që nuk e tradhtonin dhe që shihnin të heshitura vetminë e tij.

*"Çelën trëndafilat në mëngjes, / Me petale në ngjyrë të vetëtimës..*

*Trëndafilat vetëtimë në heshtje për gjëmën time...*

*"Është gjithmonë një trëndafil / Ndoshta edhe prej reje / Ose i bërë nga zëri im..*

*Jam i trishtuar. Trëndafilat e tu / Më mbetën në duar si plagë...*

*Shfaqen në muzg / Trëndafilat e thurur me diell / Ah, tani edhe trëndafilat na kujtojnë kamionët me djemtë e vranë / Sa të bukur dhe të rinj ishin, o zot!*

Trëndafilat nuk guxonte njeri t'i prekte, veç nënës së tij. Isha i ri aso kohe dhe nuk guxoja të mendoja se mund të prekej një trëndafil. Aq më tepër tek shtëpia e një idhulli që, ndërsa na kishte mahitur me poezitë e tij, na bënte edhe më kureshtarë me rrëfimet e prejardhjes së fisit të tij nga Klementinët, nga Vermoshi, datuar nga viti 1100, fis papnor dhe na dukej si orakull.

Ishte një orakull ndërsa fliste, kur heshtte kthehej në statujë.

Njihja edhe vëllain e tij, mjek dhe motrën, por ata ishin, si të thuash, paradhoma për të shkuar tek dhoma e ndjenjës së tij. Edhe aty kishte trëndafila. Lulet e para që vendosi mbi varrin e nënës së tij ishin trëndafilat e shkëputur nga kopshti i vogël i oborrit, pikërisht ata që nuk kishte guxuar njeri t'i prekte.

Iku më pas në Tiranë. Trëndafilat do të harliseshin për pak kohë. Do të kthehej në shtëpinë e vjetër, ku thoshte se dikur kishte jetuar Ded Gjo Luli dhe Hilë Mosi, vetëm për të vdekur.

I braktisur. I uritur. I tradhtuar. Si një shenjtor.

Askush nuk vuri mbi varrin e tij trëndafilat e kopshtit.

Vajta këto ditë deri tek porta e jashtme e shtëpisë së vjetër. Rrugina kishte mbetur po ajo, muret e gurtë ishin të njëjtë, mbi to ishin kacavarur disa trëndafila të bardhë, nga ata që vihen mbi një arkmort. Gjithkund heshtje.

Nuk e di pse më është kujtuar një bisedë e gjatë me të, kur mendohej se më në fund kishte gjetur Itakën e tij, dhe më tregonte se shpesh herë , mëngjeseve të burgut, duke pritur në oborrin e rrethuar nga mure të lartë dhe gjemba, tasi i mbushej me dëborë dhe ai kujtonte pikërisht këto rrugina, të cilat, në ditët e dimrit, si për të sfiduar gjithçka, çelnin trëndafilat e fundit.

I çelnin në fillimin e dhjetorit.

Në një ditë tjetër dhjetori, rishtas i vetmuar, nën trëndafilat e fundit që kishin çelur, ai do të digjte tërë dorëshkrimet e punuar në dy dekada, dhe e kishte ditur se po bënte një punë të mençur.

Më pas do të shkruante:

"Çdo ditë ka dhjetorin e vet, dhe kjo mjafton".

Isha kurioz të shihja nëse ende trëndafilat ishin në oborrin e shtëpisë së vjetër. Kisha pak hapa deri atje, krejt pak. Nëse do të ishin trëndafilat, do të ishte edhe poeti. Si një shelg i vetmuar mbuluar me dimër, i braktisur nga miqtë, zogjtë dhe gjethet... ku netët e lumtura si zilka tringëllinin në degët e kujtesës....

E mbaj mend edhe shegën e veçantë, mbjellë nga poeti Hilë Mosi në një cep të oborrit dhe kokrrat e saj që vareshin

si llampadarë. Më pas mbollën edhe një dafinë, e cila, kur nëna nuk ishte më, nuk gjelbëroi, shkruante Frederiku, vetëm zëri i tij i djalërisë jehon mbi gjethet e verdha, ndërsa dafina vendos kurora mbi lavdinë e muzgut.

*Ishte një botë e tërë kur ishe Ti / Por erdhi kjo vetmi e madhe që fshiu gjithçka.*

\*\*\*

Shpesh herë, ajo që duket e pamundur, nuk është e tillë. Ka fjalë që më tepër të trishtojnë se të çudisin. Një fotografi e Frederik Reshpjes është koncentrim i dhimbjes. Është dhimbja e një njeriu në zgrip, me pafajësi absolute. Rrallë herë tiparet e një njeriu kanë shprehur një gjendje të vazhdueshme, si ka ndodhur me Frederikun. Pas viteve '90 ai do të jetë ndër të parët që do e kuptojë se, në të vërtetë liria e krijimit ishte thjeshtë një iluzion i lirisë. I sëmurë dhe delikat, disa herë i përplasur në çimenton e të vdekurit me një gardian të tmerrshëm mbi kokë që kërkonte të dinte se si vdes një njeri, kur ndodhi e pamundura, pra e drejta e jetës, momenti kur do të vinte dita e tij dhe ai sigurisht e kishte ditur gjithnjë se Dita e tij do të ishte larg, pra, atëherë kur përballë dritares pa xhama, në shumë e shumë netë kishte pritur të pamundurën, nuk e kishte menduar se ajo përsëri do të kishte edhe zhgënjimin e saj të madh.

Do të shkruante se "Asnjëri nuk ka patur nevojë më shumë se sa unë për ishuj. Por tërë ishujt janë të rremë".

"Në lashtësi, Lukiani pyeste: cili je ti i dashur, dhe si kërkon të bëhesh perëndi përderisa leh? Kjo aristokraci pra, e thëret edhe artistin që të lehë. Nëqoftëse ndërrohen faraonët, ndërrohen edhe mënyra e të lehurit. Nuk është vetëm realizmi socialist që leh. Tërë poezia politike që lexojmë përditë, është lehje. Ka gazeta që kur i merr në dorë, të duket sikur do të kafshojnë".

Çfarë e kishte bërë heretikun e madh të kishte një pikëllim tjetër, rishtas me përmasat e një Itake që kishte kërkuar gjithë jetën dhe, kur mendoi se kishte ardhur, ajo ishte larguar përsëri?

Këtu zë fill ajo që mund të quhet pa droje tragjedia e njohur me emrin Lidhja e Shkrimtarëve dhe meskinët rreth saj, të patalentuarit, hakmarrësit e vegjël, liliputët që nuk rriteshin kurrë dhe që kënaqeshin nga mjerimi i tjetrit, mjerim të cilin vetë ia kishin përgatitur.

Historia e kësaj Lidhje është ndër më enigmatiket në historinë e komunizmit dhe më e panjohura. Me një mundim mitik ca poetë të mjerë, të neveritur, do të krijonin menjëherë pas dhjetorit 1990, një muranë të pakalueshme, që e fshehta përvëlonte të rrinte gjithnjë e mbyllur, misterioze dhe kështu edhe më e rrezikshme.

Frederik Reshpja e ka quajtur këtë, në dy kohrat, si Shtëpia Kriminale-Letare e Partisë së Punës. E ka quajtur kështu edhe kur nuk e pranonin në shkallaret e saj, edhe kur, pas ndryshimeve që dukeshin të pamundura, i afruan shpejt e shpejt një rrogë të madhe e që ai, natyrisht e refuzoi, megjithëse në ato ditë ai ishte në mesin e Tiranës pa lekë dhe pa një vend fjetje.

Drama e madhe e jetës së tij ka filluar pikërisht në këto shkallare, pastaj është sulur më tej në korridoret e

mërisë, për të shkuar në sallat komforte dhe denoncimet vdektare.

Nuk besoj se ka pasur ndonjë sallë tjetër, kaq komforte, ku janë përgatitur kaq shumë krime, e, për më tepër, ndaj njerëzve me të cilët kishin qëmtuar fjalët. Vetëm salla e madhe në selinë e Komitetit Qendror kishte parë dhe përgatitur drama të tilla, por kjo e Lidhjes së Shkrimtarëve ishte edhe më e përbuzshme, më meskine, ishte si një lloj maceje e egër që rridhte nga një tigër vrasës.

Më parë se të dënohej në një gjyq Frederiku, por jo vetëm ai, është dënuar në këtë sallë, në këto korridore, në shkallaret e saj, në zyrat, ku në makinat e shkrimit të porositura për të qëmtuar fjalët e bukura të kësaj bote, kërruseshin njerëz meskinë për të përgatitur denoncimet e ardhshme.

“U ngrita. Turma e shkrimtarëve të E. më përgjonte me sy armiqësor. I huaj! Armik!

Mjerë letërsia shqiptare! mendova. Mjerë De Rada dhe Fishta! Turmë e mjerë meskine! Mallkim i pyjeve dhe i celulozës!

Ktheva kokën dhe pashë Ismailin që më vështronte. U ngrit. Ku vete, Ismail, ke De Rada? Parisin nuk e përmendim asokohe”.

E kishte menduar se ndoshta një ditë do të kthehej përsëri në këto salla e ndofta atëherë kjo rrëmuje do të kishte mbaruar. E dinte se gjëma i kishte ardhur që këndeje, ashtu si e dinte se letrarët e qytetit të tij, edhe ata që i dolën dëshmues të rremë, ishin tepër të parëndësishëm për t'i bërë dëm atij.

Kthimi do të ishte përsëri tragjik. Ishte, si të thuash, pjesa e dytë e një tragjedia, ku, në të parën kishte qenë vdekatari i pritshëm, ndërsa në të dytën donin ta kthenin vuajtjen e tij në një grotesk.

Kur u ktheje, Jakov Xoxa kishte vdekur, Petro Marko ishte i sëmurë, Lasgushi nuk jetonte më, kishte ikur shtërgu i fundit në fluturimin e tij madhështor, Ismail që diku larg si përtej kohës, Moikomi po përgatiste kolonën e jetës së tij, Xhevahiri ishte i mbushur me dhimbje.

Viti 1991. Ai, për herë të parë, pas kaq shumë viteve, takohet përsëri me një turmë shkrimtarësh. Tani të zymtë dhe nevrinë. Mburramendës dhe “disidentë” të shpallur në kolonat e gazetës “Drita”. I kishte lënë marrëzisht të dashuruar me Enverin, i gjente anti-enveristë të tërbuar. I tha vetes një varg të famshëm të De Radës që e kishte më për zemër “Lis bota kish ndërruar”, por kallamishtet e Lidhjes nuk kishin ndërruar asgjë nga përdhunimi i jetës së tyre.

“Kishin tepruar vetëm këto anti-enveristë të tërbuar, të mjerë dhe medio-kër, si gjithnjë të gatshëm për hymne e ditirambe, nëpër shkallë e koridore. Njëqoftëse takoj Dhimitër Xhuvanin, atëherë zoti më do”!

Në të vërtetë, Frederik Reshpja ishte si një sleg i trishtuar, fatkeq si Serembe dhe që i dogji krijimet e tij ashtu si edhe poeti arbëresh. Një kristal i akullt ka qenë mbi jetën e tij. Më të shumta ia ka patur ditët me dimër dhe të paktë një pranverizim që akullohej përsëri.

Ishte dhe mbetet poeti i munguar. Shpirttharë që çuditërisht solli tek të tjerët ndjenjën e së bukurës.

Ishte e pamundur të zemëroheshe me

të. Edhe kur të shante. E dije se të do në atë mënyrën e tij të veçantë. Nëse të hapte derën, atëherë ishte i sigurtë në miqësinë e tij.

Kur dilte nga shtëpia dhe ecte nëpër shëtitoren e madhe, që asokohe i thonim “Piacë”, merrte buzë shtëpive, duke e prirur njërin sup nga e majta dhe i pabringosur nga shirat, të dukej sikur i thirrte ato. I dashuruar me shiun, si një ndër gjërat e zakonshme të qytetit rrethuar nga ujrat. Më shumë se gjithçka tjetër, Shkodrën e kishte në vete. Shqisë të tij. Përmasë njerëzore. Dashuria e tij i kishte rrënjët në vjeshtat e qytetit, atëherë kur bie dritë e verdhë gjethesh dhe lëkundën degët e shirave, në gravurën e saj që i rri e varur në shpirt; për hirin e saj prej legjende.

\*\*\*

Tërë gurët e mozaikut të kujtimeve që kam për Frederikun mund të thyhen dhe të humbasin. Si shumë të tjerë, takimet me të kanë qenë të vështira, dhe shumë herë, ai vetë i bënte edhe më të vështira.

Ai, si poet i veçantë, më i shquari poet modernist i qytetit të Veriut, kishte ngritur vetë një piramidë të kujtimeve, në të cilën nuk mund të ishte lehtësisht pjesë dhe enigmën e së cilës ishte e vështirë ta kuptojë.

Nuk e kam kuptuar edhe për diçka tjetër.

Megjithëse pas vitit 1991 ndenjat me të ishin më të shpeshta, sidomos kur ai filloi të bënte gazetën “Ora”, titullin e së cilës ia propozova unë kur ishim thirrur nga Shaqir Vukaj, asokohe drejtues i socialistëve në Shkodër, ai, asnjëherë nuk më ka folur për denoncuesit e tij.

Nuk i përmendi kurrë, nuk u shfaq asnjëherë si një denoncues i denoncuesve të tij, “lis bota kishte ndërruar” dhe as nuk u përpoq të krijonte rreth tyre dhe për to një mjedis mbyllës.

Vetëm një herë ai u përvesh keqas një figure të njohur si shkrimtar në qytetin e tij dhe, për më shumë, jo për të shkuarën, por për ditët që kishin ardhur. Pasi nuk i kishte mjaftuar që kishte qenë dëshmitar në gjyqin e Frederikut, më pas, kur filloi pluralizmi, ai ishte veshur me një petk të ri dhe e sulmonte poetin e burgosur, duke u fshehur pas emrave të tjerë.

Në vargjet e tij ai i është kthyer disa herë denoncimit, por si fenomen, si ngjarje, si një dukuri që njolloste letërsinë shqipe, por kurrë me emër të veçantë.

Nuk e bënte këtë nga shpirti i tij poetik, apo nga që mendonte se gjithkush duhej të paguajë vetë mëkatet e tij, këtë nuk e kam mësuar kurrë.

Ndoshta denoncimet dhe ditët e burgimeve të herë pas hershme bënin pjesë në ato kujtime që nuk i donte afër vetes. Ku ta dish. Shpirti donte të çlirohej nga ankthi i së keqes dhe nga mëria që djeg poezinë.

Lirika moderne e Frederikut nuk ngjan me asnjë poet tjetër shqiptar. Ndonëse në jetë ai qe një njeri modest, i trishtuar tej mase, i persekutuar me të pa të drejtë, në poezi Rreshpja do të mbetet një nga krijuesit më serioz dhe më autoritar

Frederik Reshpja i takon, po ashtu, asaj pjese të krijuesve të krishterë, katolikë, të Shkodrës, të cilët ishin shquar në lëvrimin e kulturës dhe që, deri para

vitit 1944, kishin qenë një ndër aureolat e letërsisë shqipe.

Bota letrare dhe kulturore e pjesës katolike të Shqipërisë ka qenë për shumë e shumë dekada, edhe për shkaqe të njohura historike, njëra ndër më perëndimoret dhe më të lidhura me rrënjët e kombit. Emrat e njohur të saj nuk përfshijnë vetëm Fish-tën, Koliqin, Mjedën, Prendushin, Shtjefën Gjeçovin, Ndoc Nikajn, por është shumë e shumë më e hershme. Në fakt, ajo ka qenë trugu i zgjimit të ndërgjegjes kombëtare dhe nyja e fuqishme ndërlidhëse mes botës së qytetëruar dhe mendimit filozofik dhe letrar shqiptar.

Nëse në fushën e letërsisë ajo kishte vetëm disa maja, studimet e këtyre klerikëve në entologji, folklor, filozofi, arkeologji, shkenca politike, etj., ka patur majat e paarritshme edhe në shumë e shumë vite më pas.

Përgjithësisht ajo ka qenë një kulturë e lidhur ngushtë me vendin dhe, shumë nga liderët shpirtërorë të saj, këtë lidhje të fuqishme, fe-atdhe, e kanë paguar me jetën e tyre.

Mund të thuash se, më shumë se me gjithçka tjetër, ata e kanë shkruar historinë e kulturës shqiptare, me gjakun e tyre.

Pas vitit 1944 kjo është një e vërtetë edhe më e qenësishme dhe lehtësisht e dallueshme, çka i ka bërë nder asaj elite krijuese dhe emancipuese.

Bota krijuese shqiptare në fakt hapet me këtë letërsi, tejet e kultivuar, humanitare dhe e lidhur me kombin. Shembulli i Marin Barletit, me dy kryeveprat e tij, „Rrethimi i Shkodrës“ dhe vepra e tij madhore për jetën dhe Bëmat e Skenderbeut, janë ndër fillesat e kësaj letërsie, për të shkuar më tej me Budin, Bogdanin, Buzukun – si themelartë të së bukurës gjuhës sonë. Për të shkuar më tej tek Koliqi, Fishta, Nikaj, Prendushi...

Bota e tyre është aq e gjerë, sa që, nuk mund të përmbledhet vetëm në një emër.

Megjithatë, si do të pohonte vetë, Frederik Reshpja nuk e ka parë veten kurrë si katolik, pasi, pohon ai, kombi është mbi fetë. Ai, megjithëse njohës i mirë i saj, ka luftuar të shkëputet nga ndikimi i tyre, sepse “po t'i ndiqja do të mbetesh epigon i një letërsie jashtëkohore”.

Duke qenë veçanërisht njohës i mirë i Fishtës dhe i Mjedës, që ishin edhe miq të babait të tij, Markut, do e ketë të vështirë të dalë nga ndikimi i tyre, por këtë e çmon si të domosdoshme. Kjo nuk ishte tradhti e traditës, por çuarje e saj përpara.

Dhe ai, ndoshta edhe pa vetëdijen e tij, por nga ajo që kishte pasur brenda vetes, sepse që në moshën 4 vjeçare lexon nga kjo letërsi, do të sjellë këtë frymë paqëtimi, edhe ndaj hetuesve të tij, ndaj atyre që e kishin burgosur dhe torturuar. Fryma e lirisë së shpirtit përmes faljes është në poezitë e Frederik Reshpjes shumë më e fortë se çdo ndjenjë tjetër.

*Ne të gjithë jemi anijethyer, / unë vetë rri më këmbë në fundetin tim.*

\*\*\*

Një ndër proverbat e lashta, lakonike kineze, thotë se “Urtësia e brendshme është edhe Mbretëria e Jashtme”.

Urtësinë e brendshme Frederiku e kishte nisur ta ngjiste që kur katër vjeçar do të dëgjonte e më pas të lexonte Librat e Shenjtë, por ndikimi i tij më i madh do

të ishte Nëna.

Askujt nuk i besonte si Asaj dhe askush tjetër, si Ajo, nuk do i ngjallte atij mëshirën dhe faljen. Megjithëse ende me shenjat e gozhdëve në duar, i ngarkuar me tërë trishtimin e botës, ai më shumë do i ngajë çifutëve të endur në shkretëtirë, ai ecën e ecën për të arritur atje ku ishte nisur, mbështjellur me dimrin e dhimbjes.

*Tani që po vdes ëndërroj vetëm një kryq tek koka / Dhe të harrohem se nuk dua që edhe pas vdekjes / Të më ndjekë mallkimi i Artit. / Mos e pastë njeri këtë fat!*

\*\*\*

Frederik Reshpja ka bërë vetëm një autportret për vete.

E ka bërë në vetëm pesë rreshta.

Aty janë të gjitha çka mund të thotë një poet.

Është ajri që tingëllon, zërat e të vdekurve mbetur në kujtesë, shirat që nuk i kishte njohur kurrë, lavdia që u mbyll përmes hekurave, vetmia që ka ngritur muret e saj, drurët që bëhen shpirta dhe pulëbardhat që vdesin në horizont, vargani i gjatë i orëve të pritjes, përrrenjtë prej hëne që shpesh derdhen nëpër rrugët prej ajri.

Në pesë vargje është një jetë, duke kërkuar një vend ku dhembja të mbështesë kryet.

#### PËR VETEN TIME

*Këndoi bilbili i vetmuar deri në dhembje / Por askush nuk e dëgjoi zërin e tij / Sepse i mungonte kafazi.*

*Mbi një pedestal heshtjeje / Dergjet profili im që në lindjen e gurit.*

\*\*\*

Frederik Reshpja ka qenë një poet i burgosur. Disa herë. E, megjithatë, ndryshe nga shumë të tjerë, nuk ka poezi të burgut. Më pas, në lirinë e tij të shkurtër, ka shkruar, më shumë në prozën e tij poetike, për momente të burgut, por poezi të mirëfillta, nuk ka shkruar.

Askush nuk e di se si ka ndodhur kjo. Në hyrje daljet e tij të shpeshta si i burgosur politik, kohë që rëndohej më tepër nga hetimet e gjata, ai nuk ka bartur me vete poezi të një të burgosuri.

Si duket, ai e ka përjetuar edhe kohën kur ishte i lirë, si një robëri shpirti dhe, kur ishte i mbyllur, dy herë i palirë, ka ruajtur ndjenjën, atë shpirtin e tij heretik dhe demoniak, i bindur se, duke ecur, stapin e kishte harruar te një mjegull, ndoshta edhe në kopshtin e fëmijërisë, ku i dukej se barisnin të vdekurit dhe ngrohnin duart mbi flakët e trëndafilave.

Një herë, vetëm një herë, e kam pyetur përse në burgimet e tij të herëpashershme, nuk kishte shkruar poezi, pra, përse nuk kishte bërë atë që kishin bërë shumë të tjerë, që nga një emër i njohur i letrave shqipe, Arshi Pipa e deri tek poetët më minorë?

“Unë prisja ditën time, ditën që e dija të pamundur, por që do të vinte. Shumë netë, përballë dritares pa xhama, ndërsa shihja yjet si një budalla, ndoshta krejt i çmendur duke pritur një kumt nga Nëna, kur ujrat kishin ngrirë, i pabindur, mbështjellë me një batanije të hetuesisë, më shumë ngjaja si murg franceskan, mendoja vargje të ndryshme, vinnin tek unë si shirat e pikëllimit

tim në një breg deti.

Pastaj vinte dita, yjet zhdukeshin, kumti nga Nëna nuk vinte, prisja perëndimin si një vrasës me thika në duar dhe e dija se vdekja nuk do të më vinte në burg.

Njerëzit në burgje shkruajnë sepse shpresa u është vrarë. Poetëve në burg edhe dritat e rrethojave të burgut nganjëherë u duken si portokallet që i lëkund era në muzg. Sepse poetët janë thirrur në këtë botë për të kënduar bukurinë e shpirtit njerëzor, tronditjet dhe mirësinë, çastin e përjetësinë.

Kam qenë poet i pabindur, sepse isha njeri i pabindur. E dija gjithmonë se dita ime ishte diku, ishte një hapësirë ku më në fund të merresha me letërsi dhe t'u tregoja njerëzve se sa fort i doja.

Në burg e ndjeja këtë hapësirë, por nuk e kapja. Unë kisha shpikur kohën time, Itakën time dhe fjalën time. Koha nuk ishte e rëndësishme”.

Si shumë poetë të tjerë, të burgosur si ai, nuk kërkoi kurrë revanshin. Miti i hakmarrjes ishte i kundërt me besimin e tij njerëzor. Mund të kishte bërë dhjetra denoncime të atyre që e linçuan, por u mjaftua me përbuzjen dhe, nganjëherë, me një goditje të rëndë, në një mënyrë të vjetër burgu.

“Para njëzet vitesh, në një nga dhomat e hetuesisë në burgun e vjetër të Tiranës, jam ballafaquar me një dëshmitar kokëfortë. Ai ngulte këmbë që unë kisha sharë Enver Hoxhën. Kur e pashë se po qante për shenjtërinë e E.H. e godita. Mua më vunë prangat dhe më thyen kyçet.

Tani, pas njëzet vjetësh, ky erdhi dhe më shtrëngo i dorën.

-Kujdes – i thashë. Unë e kam dorën e thyer, ti e din.

-Kam dëgjuar se nuk je anëtar i P(X).

-Jam tepër i vendosur në lirinë që e kam fituar vetë. Unë kam humbur çdo gjë në jetë për këtë liri.

-Atëherë, ti qenke enverist,-më tha.

E godita tepër rëndë, me një mënyrë të vjetër burgu aty te shkallët e Lidhjes. Ra praptas. Gojën e kishte me gjak. Më erdhi turp. Desha ta ndihmoja por nuk mund ta prekja me dorë. Neveri“!

Edhe poezia e tij nuk ka revansh,

klithma, britma, sherr, qoftë edhe sherr poetik. Megjithëse i vuajtur, ai e filloi rikthimin e tij nga koha zero. Kërkonte të dielën e tij, dhe, kur ndjeu se fundi do të ishte i pamëshirshëm, shkroi me dhimbje se “Tani mund të them se në të vërtetë, nuk kam pasur asnjë të diel në jetën time. Kam qenë shumë fatkeq në kalendarin e ditëve, sidomos mungesën e të dielës e kam ndjerë shumë”.

Ai nuk ia lejoi vetes dallimin e ditëmbit të vetvetes. Edhe në çastet më ngazëluese nuk u deh kurrë pas fuqisë së artit të tij; gjithnjë më pranë ndjente vdekjen se jetën; më shpesh ishte demon se sa një njeri i urtësuar; ai i shtyn orët e fundit të jetës së tij nën dritëzim argjendor të një bote poetike, krijuar kurdoherë në zgripin e vdekjes.

Duke perifrazuar Stevan Cvajg-un, në librin e tij për filozofin poet, Niçe, që kurrë nuk shkroi poezi, do të thoja se, shpirti i tij lirik dhe demoniak njëkohësisht u largua në një terr fshehtësie dhe në një vetmi prej shenjti.

Dy poetë veriorë të papërsëritshëm, Migjeni dhe Reshpja, çuditërisht banues pranë njëri tjetrit, hapësirën e të cilëve e ndante vetëm një kuvend françeskan, do të kishin shumë të përbashkëta me Niçen, me frymën e tij, me dritën e qashtë, të ftohtë dhe mjegullore, të njëjtë në varfëri dhe shpërfillje, të ndaluar dhe të dashuruar njëkohësisht, kërkues të Mbinjeriut dhe, së fundi, të vdekur dhe të ringjallur disa herë, duke shkuar nga vdekja në ringjallje, nga harresa në piedestal, nga linçimi në adhurim dhe, si për të qenë të njëjtë në gjithçka, edhe vdekje vetmitare.

Reshpja, njëjtë si Migjeni, e ndjen veten poeti që në çastin kur provon të hyjë forcërisht, deri diku përdhunshëm, ndër kohrat moderne të poqzisë, ndaj, as njëri e as tjetri, nuk kanë të përbashkëta me poetët pararendës të qytetit Verior; ata marrin rrugën e paprerë të gjëmimeve, shpallin kredon e tyre poetike dhe, ashtu si Niçe, nuk janë të gatshëm të mos jenë tragjik dhe të parakohshëm. Ata, lehtësisht, janë njerëz tragjikë dhe poetë tragjikë; të vetmuar, poezia e tyre nuk mund të kuptohet pa dukurinë e përplasjes; në kohra të

ndryshme kanë mision të njëjtë, por flijimi është i ndryshëm.

Atyre, më shumë se gjithçka tjetër, i përshtatet thënia e Niçes, se „Në i mbafsh gjatë sytë për greminë, atëherë edhe greminat nis e vështron nga ti“.

Ata e vështruan gjatë, shumë gjatë, greminën njerëzore në dy kohë të ndryshme dhe, si në një parathënie tragjike, edhe greminat mbajti sytë mbi to, deri sa ranë në thqafjen e jetës së tyre të shkurtër.

\*\*\*

Kur Frederiku vdiq, lodhur nga jeta, vetmitari më i madh i letrave shqipe, poeti si një erë mbi ëndrrat e pyjeve, me fjalët që i kishin mbetë pa thënë, me dëshirën që shkallët e kësaj nate t'i ngjiste me dikë deri tek hëna, ku do të shkonte i vetëm, ai e kishte thënë parafjalën e tij, “O ajër i mbrëmjes, mbështillmë, erdhi ora të vdes përsëri“.

Ishte shkurt, një i ftohtë i mbështjellur me mjegull dhe vetmi njerëzore. Dimri ende nuk kishte ikur dhe jo të gjithë dëbornat kishin rënë.

Tërë vdekja u rrëzua në fushën me shi...

17 shkurt 2006.

Ditëvdekjen e tij, ashtu si dhe ditëlindjen, shumë e kan harruar.

Në pragun e vdekjes dukej sikur kishte dalë nga Guernika e një nate të gjatë.

Dukej më i plakur nga sa ishte. Në të gjitha vitet e tij nuk kishte pasur asnjë stinë të re. Vjeshtë dhe dimër që përsëriteshin.

Në luginën e vdekjes e prisnin kuajt e marsit, ngjyrat ishin kthyer në shpirta, ndërsa barbarët dukej sikur kishin ikur përkohësisht dhe ishin rikthyer.

Po bënte paqe me veten! Tashmë, në netët e tij, nuk do të shihte një anije të bardhë. Në mëngjes, një trandafil i kuq kishte çelur tek porta e shtëpisë. Pjesë lamtumire? Dorë e zgjat përmes petaleve? Mos ishte loti i nënës shndërruar në një trandafil?

Shega e mbjellur nga Hilë Mosi ishte ende aty, sikur kërkonte dhe priste dëshminë e saj për ikjen e poetit.

Në qiellin e dimrit të jetës së tij ai po ikte si një gjethe e fundit, ndërkohë hëna

ishte shuar.

Nuk kishte kohë të thonte lamtumirë. Si duket, e kishte thënë prej kohësh. Pas tij nuk kishte më zogj, fluturimet u fshinë, në cilën dorë të botës do e zinte gjumi i përtej jetës?

Disa kohë më parë kishte shkruar:

*Atje te ishujt e kaltër, / Pashë portretin tënd në horizont. / Ç'ban aq larg, dhe përse u bërë re?*

*Unë do të mbetem në këtë tokë që quhet Shqipëri. / Atë ditë ti zbrit dhe sillmë një trëndafil prej shiu!*

\*\*\*

Shpesh herë, ndërsa jam në rrugët të qytetit tim, Shkodrës dhe eci në rruginën e ngushtë që të çon drejt shtëpisë së Frederikut, ku ende bulojnë trëndafilat dhe mbi mure kanë dalë shermashekët, më pëlqen të mendoj për poetin, ndërsa ndjej hapat e njeriut, që e kam dashur më shumë në pikëllimin e tij, ndoshta edhe nga që nuk e njoha, veç fare rrallë, në çaste gëzimi.

Në rininë time kam qenë dishepull i tij, poezia e Frederikut më trondiste dhe për shumë kohë ia thoja vetes.

Më vonë, kur përmbysja kishte ndodhur dhe gjithçka kishte qenë fillimisht e madhërisht, por kurrë e plotë, kam menduar se cila ishte ajo gjë e veçantë, krejt e veçantë, e cila ishte ngjizur në poezitë e tij, çfarë e kishte bërë atë poet rebel, në fund të fundit ai kishte pasur një devizë, që duhej të ishte mbi të gjitha.

Hemingueji ka shkruar se “Letërsia e madhe lind nga njohja e padrejtësisë“.

Këtë Frederik Reshpja e kishte ditur më herët se shumë të tjerë. Dhe e kishte ndjekur, duke e ditur se mund të thërmohej.

*S'dua të trishtohet kush për fatin tim / Se për fatin tim trishtohem vetë / Mermeri i thyer i Perëndisë së Humbjes / Tërë lavdia ime kjo ka për të qenë...*

Nga, gazeta “DITA”, 10 gusht 2019

## Mhill Dede Logu, u nda nga jeta!

Mhill Dede Logu u nda nga jeta me datën 09 korrik 2019.

Mhill Logu, 90 vjet më pare lindi në fshatin Lekaj, të krahinës së Shalës, në një truall me tradita atdhetare, ku lindën burra të shquar për urti e trimëri, për burëri e fisnikëri dhe njeri prej tyre ishte dhe Mhilli. Ai mori gjithçka të mirë aty ku lindi edhe nga gjyshi i tij nga nëna, Dede Lulash Perani, nga fshati Lotaj, bashkëluftëtar besnik i Mehmet Shpendit.

Në rininë e tij, ai u dallua në mes të tjerëve si një malësor i ri me tipare tipike malësore, i etur për dije e progres, pjesëmarrës aktiv në aksionet e para të rinisë e në aksionin e madh nacional për zhdukjen e analfabetizmit në fshatin e tij e më vonë në vitet 50-t si edukator i brezit të ri, mësues në fshatin Lekaj, Abat, Theth e në fshatra të tjera të Dukagjinit.

Në vitet 60-t u zgjodh për të punuar në detyrën e Drejtorit të Shtëpisë së Pushimit në Theth dhe me vone për disa vite në detyrën e kryetarit të kooperativës bujqësore në fshatin Lekaj, Abat e Pecaj.

Kudo, ai ku punoi e drejtoi tregoi dashuri për fëmijët në shkollë, tregoi thjeshtësi e korrehtësi me pushuesit e turistet e shumtë, që vinin në Theth, në përpjekjet maksimale për të rritur të ardhurat e mirëqenien e bashkëfshatarëve.

Ai ishte i ndershmë, i thjeshtë dhe i përgjegjshëm në punë e tij.

Mhilli, ishte një bashkëshort i devotshëm dhe një baba i mire i dy djemve e dy vajzave, Zefit e Lapid, Luçes e Liljanës.

Prej disa vitesh, në SHBA bashke me djemtë e familjet e tyre, por dashuria e malli për atdheun e për njerëzit, për shokët, miqtë e dashamiret e tij të shumte bëri, që ai të kthehej në Shkodër para 5 vitesh, për ta mbyllur jetën e tij aty ku balta është më e ëmbël se mjalta.

Ai dinte të shijonte jetën, të kënaqej



me djemtë e vajzat, me nipat e mbesat, të cilët gjyshin e tyre e rrethonin me respekt e me shumë dashuri.

Ai kënaqej me faktin, se djali i dyte, Lapi, u bë këngëtar i mirënjohur si në Shqipëri edhe në diasporë.

Por, kënaqësi të madhe ndiente për vajzën e dyte, Liljana

Luani (Logu) si mësuese e pasionuar, e cila me një ndjejnë të larte përgjegjësie e shpirt sakrificë mori përsipër një mision fisnik e human për shkollimin e fëmijëve të ngjuar nëpër fshatrat e Shkodrës e të rrethëve të tjera. Për ketë i janë dhënë çmime e vlerësime nacionale e ndërnacionale, si: “Ambasadore Universale e Paqes”; “Trëndafil i Arte”, për kontribut e dhënë në fushën e edukimit e shkollimin e fëmijëve të ngjuar; “Gruaja Kurajoze” e dhënë nga ambasada Amerikane, në emër të Sekretarit të shtetit të SHBA; “Mësuesi i vitit 2018” e dhënë nga Ministria e Arsimit, ARCC dhe Global Teacher Prize; përzgjedhur nga Globak Teacher Prize, nder 50 mësueset më të mira në bote, për

punën dhe misionin fisnik; “Certifikate Mirënjohje” e shumë çmime të tjera.

Misioni i dyte po aq i rëndësishëm ishte përkujdesja dhe për prindërit e saj, e cila edhe me ndihmën e motrës e te dy vëllezërve në emigrim u krijoi atyre të gjitha kushtet e nevojshme të jetesës.

Me shumë respekt kujtojmë nipin e Mhillit, Rrok Logun, ishe ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Vatikan, i cili një vit më pare u nda nga jeta.

Theksojmë, se Shoqata e Miqësisë dhe e Bashkëpunimit “Shqipëri-Itali” i ka dhënë titullin “Anëtar Nderi i Shoqatës”, pas vdekjes.

Mhilli, me 10 korrik 2019 u percoll për në banesën e fundit, duke lenë në pikëllim të thelle bashkëshorten, Tone, dy djemtë e dy vajzat, nipa e mbesa për humbjen e njeriut të tyre të dashur.

Ne, shokët e tij, veteranet e pas-veteranet e tyre humben një shokë, me cilësi e virtyte të larta morale e shoqërore, prandaj përkulemi me shumë respekt para trupit e emrit të tij.

Nga Martin Cetina e Ndoc Grimaj

# I MADHI ISMAIL KADARE I PËRKET JO VETËM SHQIPËRISË, POR MBARË NJERËZIMIT

Alfred Papuçiu


Isha i ftuar, pas kthimit tim nga Shqipëria, nga profesori i shquar zviceran, mik i shqiptarëve, Jean-Philippe Assal. Në bisedë e sipër i thashë i entuziazmuar se pata fatin të takohem dhe të bisedoj edhe me shkrimtarin Ismail Kadare. Profesori i nderuar më foli me dashamirësi për shkrimtarin tonë mbarëkombëtar që e kishte takuar gjatë vizitës së tij, para disa vitesh në Shqipëri. Më pyeti si është me shëndet? Ju përgjigja që m'u duk tepër mirë, megjithë ngarkesën e madhe që përballon. Vetëm gjatë qëndrimit tim prej gjysëm ore, u bënë disa telefonata dhe bashkëbiseduesve të shumtë, ai u përgjigjej me respekt e dashuri. Kishte marrë çmimin e Princit të Asturias për letërsinë. Cmim që shpërblen gjithë veprën e tij. Ky çmim i jepet çdo vit që nga 1981 një njeriu « puna krijuese e të cilit përbën një kontribut të rëndësishëm për kulturën universale, në fushat e letërsisë ose të linguistikës ». Pak më parë kishte marrë edhe titullin « Doctor Honoris Causa » nga Universiteti i Palermos. Gazeta franceze «Le Monde» e cilëson veprën e tij në 100 më të mirat në botë. Shkrimtar i përkthyer në mbi 40 gjuhë të botës. Ismail Kadare « i ka kapërcyer kufijtë për t'u bërë një zë universal kundër totalitarizmit ». Ai është cilësuar nga shkrimtarë të sërës së tij të njohur në botë si : « krijues i një universi të rallë letrar », « iluminist dhe humanist, njeri i lirë dhe një demokrat i flaktë », « transmetues i mendimit, ideologjisë, dëshirës për liri ». Në 2005, ai laurohet me prestigjiozen « Man Booker International ». Më tej, ai ka marrë edhe çmime të tjera.

Isha para një njeriu të madh dhe të them të drejtën e ndjeja veten pak ngushtë, pasi më dukej se po i merrja nga koha e tij e çmuar. Por ai me fjalët e tij të përzemërta më bënte të përgjigjesha, pak me ndrojtje. Me autografin e tij karakteristik, më dhuroi dy libra të tij të rinj. I dhashë edhe unë dy libra të mij, në të cilat kam shkruar edhe për të dhe më falenderoi. Por duke i parë ato në dy gjuhë, m'u drejtua ashtu thjesht : « Është punë e madhe, Alfred, të shkruash në dy gjuhë ». Ju përgjigja se e bëj që fëmijët shqiptarë në diasporë të mos harrojnë gjuhën amtare. Nuk po zgjatem në hollësitë e bisedës sonë, pasi ajo lidhet me botimet, botuesit, vendin e letërsisë sonë në Shqipëri, por dhe jashtë saj. Me dashamirësi, për shkrimtarët bashkëkohës të vendit të tij, por edhe të huaj.

Ndërkohë, bie zilja tek dera e apartamentit të Ismailit, ai shkon vetë atje të hapë derën dhe hyjnë dy zonja. Më kërkoi falje disa minuta, por gjithmonë unë isha pranë tij. Biseda me to kaloi tek realizimi i një filmi për fisnikun tonë Ismail Kadare. Me shumë modesti, ai u përgjigj se ai është akoma në fazat e para. Megjithëse po atë ditë ai po përgatitej të shkonte për pushime, e vazhdoi bisedën me dy zonjat dhe dëshirës së tyre për të realizuar një intervistë, ai ju përgjigj pozitivisht,

natyrisht pas mbarimit të pushimeve. Pas ikjes së tyre, e vazhduam bisedën në tavolinën e tij të madhe, ku nuk kishte asnjë sekretar që ta ndihmonte në morinë e gjithë atyre letrave që ai kishte marrë nga dashamirët e shumtë shqiptarë, por edhe të huaj. E vetmja « sekretare » e tij, është bashkëshortja Helena, e cila, i qëndron gjithmonë. U ndamë sikur të ishim miq të vjetër, megjithëse unë e kam takuar vetëm disa herë, kur ka ardhur në Zvicër. Më

E bëra këtë hyrje, të dashur lexues, jo për t'ju përgjigjur polemikës boshe të ndonjë pene shqiptare që «do të vrasë larg». Duam a s'duam ne, Ismail Kadare nuk i përket vetëm Kombit tonë, por botës letrare europiane dhe ndërkombëtare. Ai i përket mbarë njerëzimit. Është pararendës i njohjes së letërsisë shqiptare në botë. «Gjenerali i ushtrisë së vdekur» dhe veprat e tjera të tij, hyjnë në fondin e artë të letërsisë botërore. Qysh



kujtohet takimi i ngrohtë me shkrimtarin Ismail Kadare, nga fundi i vitit 1994, në Universitetin e Gjenevës, kur më dha me autograf një nga librat e tij që e mbaj me kujdes, me veprat e tjera të tij, në pjesën ballore të Bibliotekës sime. Më kujtohen gjithashtu takimet e rralla me të, tek Panairi i Librit në Palekspo të Gjenevës dhe jam tepër i gëzuar kur shoh se në libraritë më të mëdha edhe në bibliotekat e shumta jo vetëm në Gjenevë, por edhe në qytete të tjerë, si në bibliotekat e organizatave ndërkombëtare, ku kam punuar, emri i Ismail Kadaresë zë një vend të veçantë. Në Bibliotekën madhështore të Pallatit të Kombeve në Gjenevë, ku kam patur fatin të punoj në fillimet e viteve 90, kërkoheshin dhe lexoheshin me kënaqësi veprat e shkrimtarit Ismail Kadare. Dhe unë isha krenar që vija nga « vendi i Kadaresë ».

i ri ishte ambicioz dhe energjik dhe me penën e tij shumë shpejt u imponua për të rezatuar letërsia shqiptare në Europë, megjithë censurën e diktaturës enveriane. Gazetarë të shquar, veteranë të televizionit zviceran, si Pjer Bardë, që ka realizuar me qindra e qindra emisione përfshirë edhe për etruskët, në bibliotekën e tij të pasur, ka radhitur në një vend ballor, të gjitha veprat e Ismail Kadaresë, të botuara në frëngjisht, por gjithashtu edhe në gjuhë të tjera të huaja. Enkas, në udhëtimet që kam patur fat të bëj në botë, si rezultat kryesisht i punës me organizatat ndërkombëtare, «gërmoj» në libraritë dhe bibliotekat e këtyre vendeve dhe shoh se librat e Ismail Kadaresë zenë një vend nderi në raftet e tyre. Shpesh pyes për aksh libër të Ismailit që nuk ndodhet aty dhe librashitësja thotë me dashamirësi se tanimë është blerë. Deri më sot nuk kam

gjetur asnjë libër te Kadaresë në kioskat apo tezgat e shumta të librave tashmë të lexuar e stërlexuar, pasi ato ruhen në bibliotekat e njerëzve të thjeshtë, të atyre të kulturës, të artit, por edhe të personaliteteve më të larta të vendeve të botës.

Askush nuk mund ta përlyejë figurën madhore të Ismail Kadaresë dhe të letërsisë shqiptare. Për Ismail Kadarenë nuk mjaftojnë as disa qindra faqe të tëra për të shkruar për veprën e tij, për jetën e vrullshme, për karakterin tepër njerëzor, maturinë, pjekurinë, inteligjencën dhe bonsensin e tij. Ato i gjen të shkruara në qindra e qindra botime kudo në botë. Kemi fat që një "Doctor honoris causa" është shqiptar, kemi fat që vepra e tij ndodhet kudo: në Kongresin amerikan, në Bibliotekën më të vjetër të botës, themeluar në shekullin e XII-të në Oksford të Anglisë, në Universitetin Jale (SHBA), tek "Payot", "FNAC". Një akademik francez ka thënë për Ismailin tonë: "Toujours vous porterez l'Albanie et toujours l'Albanie vous portera" (Ju do të mbani gjithmonë Shqipërinë dhe Shqipëria do t'u mbajë). Shqiptarët, siç është shprehur vetë shkrimtari ynë, "e humbën Europën" dy herë, në radhë të parë në shekullin e XV-të, si popujt e tjerë nga zgjedha otomane; radhën e dytë, pas Luftës së Dytë Botërore, kur ranë nën thundrën komuniste; herën e tretë, megjithëse jetojnë akoma nën "ankthin" se mos e shohin akoma veten jashtë Europës, Ismail Kadare, ithtar evropian i shqiptarëve dhe ata që e pasojnë, do ta vënë në jetë aspiratën e bashkëkombasve të tyre, me veprat e tyre, për ta parë edhe Kombin tonë në Brukselin e të 27-tëve. Japonezët, Norvegjezët, Baskët, Italianët, Britanikët, Grekët, Amerikanët, Portugezët, Zviceranët dhe natyrisht Francezët kanë qënë lexuesit e parë të Ismailit tonë dhe janë besnikë ndaj tij, do apo s'do ndonjë Akademik shqiptarofolës, apo ata që për dy kacidhe hedhin anatema ndaj tij. Lexuesit e shumtë të veprës së Ismailit në botë janë mësuar të deshifrojnë qysh në kohën e diktaturës së E.H., mesazhet që përmbanin veprat madhore të Ismail Kadaresë. Francezi i shquar Moris Dryon (Maurice Druon) ka deklaruar për Ismailin fisnik: "dëshmitar i Shqipërisë për Shqipërinë, ju u kthyet në universal" (botëror). Ismail Kadareja ka bërë shumë edhe për Kosovën. Mjafton të përmendim letrën që i ka dërguar para disa vitesh ish Presidentit Francez, lidhur me masakrat e serbomëdhenjve. Ai shkroi aq bukur parathënien e librit të Ibrahim Rugovës "Ceshtja e Kosovës" që u botua nga shtëpia botuese me prestigj "Fayard". Anatemat kundër Ismail Kadaresë godasin indirekt dhe çdo shqiptar të ndershem kudo qoftë. Kadareja nuk i përket vetem kombit tonë, por edhe kombeve të tjerë, ku ai ka fituar zemrat e miliona njerëzve me shkrimet e tij për Shqipërinë dhe shqiptarët. Midis të tjerëve mund të përmendim lexuesit e veprës së Kadaresë, etnologët e huaj, veçanërisht francezë, të cilët janë magjepsur nga romanet

# INTELIGJENCA DHE VARFËRIA

Legjenda e biologjisë, amerikani James D. Watson (1928), mbajtës i çmimit Nobel, që në vitin 1962, ka thënë: "Për nga natyra, unë e shikoj të arthmen e Afrikës të errët për faktin se, të gjitha testet tregojnë se inteligjenca e afrikanëve është më e ulët se ajo e jona".

Ëatson, nuk është biologu i parë dhe i vetëm që spjegon se, kuota e inteligjencës së lëkurerrtëve është më e ulët se ajo e lëkurëbardhëve.

Në vitin 1994, psikologu Richard Herrnstein (1930-1994) dhe politologu Charles Murray (1943), në librin e tyre me titull "The Bell Curve" (Rezultatet e testeve të inteligjencës) deklaruan se, inteligjenca e lëkurerrtëve është, të paktën, një herë më e ulët se ajo e lëkurëbardhëve. Ata eksperimentuan dhe testuan fëmijë të moshave të ndryshme shkollore, nga viti 1975 deri në 1990.

Profesori i Universitetit të Californisë, psikologu Arthur Jensen, 25 vjet më parë kishte deklaruar se, pjesa më e madhe e fëmijëve amerikanë, me rezultate të dobëta mësimore, janë lëkurerrtë. Sipas tij, kjo vinte për faktin se kuota e inteligjencës së tyre, në krahasim me të bardhët, është shumë më e ulët.

Në periudhën e skllavërisë, regjimi amerikan, ua ndalonte lëkurerrtëve arsimimin dhe kontaktin me librat. Një sjellje e tillë atje zgjati me gjenerata të tëra. Në raste të rralla, fëmijët lëkurerrtë, mund të shkonin në shkolla të veçanta, të ndara nga ato të fëmijëve lëkurëbardhë, ku gjithëçka ishte mizerabël. Sipas Jensen, Herrnstein, Muray dhe Ëatson, një sjellje e tillë e regjimit ndaj fëmijëve lëkurerrtë bëhej

me qëllim për tua demtuar inteligjencën atyre dhe për rrjedhojë aftësinë intelektuale. Një gjë e tillë do të arrihej nëpërmjet mosshkollimit dhe varfërimit, material dhe shpirtëror.

Psikologët francez, Christiane Capron dhe Michel Duyme, u muarën për disa vite me rradhë, me teste dhe eksperimentime, për të vërtetuar ndikimin e varfërisë mbi shkallën e zhvillimit të inteligjencës tek individ. Ata, si objekt të eksperimentimit, zgjedhën fëmijë të adaptuar. Kryesisht fëmijë me prejardhje nga familje të varfëra, të adaptuar nga familje të pasura. Gjithashtu ata eksperimentuan edhe faktin se, çfarë ndodhë me fëmijët e familjeve të pasura kur adaptohen nga të varfërit.

Hulumtimet e gjata i çuan ata në konkluzionin se, fëmijët e familjeve të pasura, në të gjitha rastet kishin një kuotë më të lartë të inteligjencës se ata të familjeve të varfëra.

Konkluzioni i dytë ishte se, rrethanat sociale dhe ekonomike të familjes adaptuese, ushtrojnë një influencë të madhe, mbi intelektin e fëmijës së adoptuar. Fëmijët e familjeve të pasura, të adoptuar nga familjet e varfëra, mesatarisht kishin një kuotë të inteligjencës prej 107, 5 pikësh. Fëmijët e familjeve të pasura, të adoptuar nga familje të pasura, kishin kuotën e inteligjencës 119, 6 pikë. Siç shihet ndryshimi prej 12 pikësh, është i konsiderueshëm. Kjo tregon se mjedisi ka një influencë shumë të madhe mbi zhvillimin apo moszhvillimin e inteligjencës. Dhe kryesisht është varfëria.

Psikologëve ju interesonte edhe fakti se, çfarë ndodhë me fëmijët e një familje, disa nga të cilët adoptohen nga familje të pasura dhe të tjerët rriten në familjen e tyre biologjike, të varfër.

Në testimet e inteligjencës së tyre, u vu re se, fëmijët e adoptuar arritën kuotën

107 deri 111 pikë ndërsa, ata, të rritur në familjet e tyre të varfëra, arritën vetëm kuotën 95 pikë. Një diferencë kjo shumë e madhe, për fëmijë të të njëjtit bark. Nuk kishte asnjë pikë dyshimi se, shkaku ishte mjedisi social dhe veçanërisht varfëria.

Psikologët vazhdonin të hulumtonin edhe raste të tjera të mundëshme, për ta bërë sa më të qartë influencën e varfërisë mbi inteligjencën. Zgjedhën dhe fëmijë të lënë pasdore dhe të adoptuar vonë nga familje të pasura.

Nga më se 5000 akte adoptimi, Michel Duyme zgjodhi disa nga fëmijët e moshës 5-6 vjeç, të keqtrajtuar në familjet e tyre biologjike. Tërheqja e tyre nga prindërit ishte berë nga organet vendimmarrëse dhe, shumë prej tyre, përfunduan në fëmijë të adoptuar. Këta fëmijë, para se të ndaheshin nga prindërit e tyre biologjikë, sipas testeve të bëra kishin arritur kuotën e inteligjencës vetëm 60 deri në 86 pikë. Psikologun Duyme e alarmoi një rezultat i tillë. Fëmijët me test inteligjence nën 80 pikë mendohen fëmijë problematikë të shendetit mendor. Çfarë mund të bënte, edhe më i pasuri, me fëmijë të tillë!?

Nga testimet që Duyme iu bëri këtyre fëmijëve, tashmë jo më fëmijë por, në moshën e adoleshencës, 12-18 vjeç, pa se, ata që ishin rritur në familje me nivel mesatar jetese, e kishin përmirësuar kuotën me 8 pikë ndërsa ata të rritur në familje të pasura e kishin përmirësuar kuotën me 19,5 pikë.

Varfëria qëllon mbi fëmijët me dy "gryka": Mbi shëndetin fizik dhe mendor.

Mjerisht, tek ne, nuk ka as studime dhe as statistika për kuotën e inteligjencës së fëmijëve. Ne merremi me politikë dhe, jo me shkencë. Kështu siç drejtohet kombi ynë, edhe për shumë dekada, do të mbetet "Botë e Tretë"

Hej, politikanë të çmendur, ku po e

çoni kombin?

Jemi kombi më i varfër në Europë.

Kjo do të thotë që, rinia e jonë, është me kuotën e inteligjencës më të ultë në Europë!

**LEKË IMERAJ**

*shkrimtar dhe përkthyes*

Nga NDUE MICI

**MAJI I LULEVE**

Maji i rinisë,  
I luleve dhe i dashurisë!

Maji i trandafilit,  
I zambakut dhe i zymbylit!

Në maj çel jargavani e marangjyli  
Vijnë zogjtë dhe dallëndyshet  
Këndojnë thëllanxat e bylbyli!

Njerëzit nga fusha e male,  
Prroje e zalle,  
Me kangë, dajre e lodra  
Ikin nga fusha e ngjiten në kodra!

Tuj këndu bashkë me bylbyla,  
Tuj mbledh vjollca e karajfila,  
Me zambak e me zymbyla,  
Lule bore trandafila!

Në male kthjellon natyra  
Dhe njerëzve u qesh fytyra  
Të rinjëve, meshkuj e femra  
U qeshin sytë, u gëzohet zemra!

e tij, në të cilat ata kanë gjetur tema që për ta janë të shtrenjta: nderi dhe fjala e dhënë, mikriptja, martesja, por gjithashtu identiteti kombëtar, transmetimi gojor, epopeja. Vepra e tij shpesh duket, për këtë arsye, si një dritare mbi një shoqëri dhe një kulturë që më parë ishin të mbyllura për etnologët e huaj, deri në 1990 dhe që për shkak të "hermetizmit" të shoqërisë shqiptare deri atëhere, ishin të panjohura në krahasim me vendet e tjera të rajonit. Ismail Kadare është cilësuar me të drejtë nga studjuesit e letërsisë botërore si "antikongformist", "rezistues i heshtur", "një kundërshtar i heshtur i regjimit", deri sa u kthye në një aktivist i palodhur kundër tiranisë. Ai është një shkrimtar gjeni, vepra e të cilit u kthye në një simbol shprese. Veprat e Kadaresë tanimë janë bërë pjesë përbërëse e shpirtit të të rinjëve, të atyre mësuesve atje në fshatrat e thella dhe në malet tona që lexonin veprat e tij dhe mësonin gjuhë të huaj, në vend që të ktheheshin në saharoshë kafenesh. Ismaili ishte simbol i emancipimit dhe formimit të tyre kulturor. Ai u kthye në një idhull për një numër krijuesish të rinj që guxonin të shprehnin disa mendime antikonformiste në veprat e tyre. Ismail Kadaresë ju desh të përballojë me dinjitet thëniet kërcënuese: "Dëgjo Ismail! Partia dhe populli të ngritën në Olimp. Në rast se ti nuk qëndron besnik idealeve tona, ata do

të hedhin në humnerë". Kërcënim i hapur në praninë e gruas së Diktatorit. Por Ismail Kadare nuk ishte më një shkrimtar modest i viteve 60-të dhe veprat e tij tanimë ishin botuar jo vetëm në Francë, por edhe në vende të tjera. Inteligjenca dhe pena e tij e mprehtë ishin mbi diktaturën, o ju kritizere qaramanë që shpini pa dashur ujë tek mulliri i serbomëdhënjve dhe atyre që duan të na denigrojnë me "mashat" tona mjerane!

Nuk dua të përmend akoma më tepër titujt që ka marrë Kadareja në Francë apo gjetiu, përveç atyre që përmendëm më sipër, apo sa kryetarë shtetesh njohin më mirë Ismail Kadarene dhe veprën e tij, se sa një president republikë të çdo vendi qoftë. Duam a nuk duam ne, ai nuk ka nevojë për ne, ne kemi nevojë për të, për gjithëçka ai do të shkruajë edhe tani edhe në të ardhmen për kombin e tij të lashtë.

Për respekt të atyre që e vlerësojnë letërsinë shqipe dhe Ismail Kadarenë, po ju jap lexuesve vetëm disa pasazhe të vlerësimeve që ju bënë atij, më 28 tetor 1996, kur ai u pranua si anëtar bashkëpunëtor i huaj i Akademisë së Shkencave Morale dhe Politike të Francës. Ismail Kadare zuri atëhere vendin e filozofit dhe moralistit të madh Karl Popper. Presidenti i asaj Akademie Zoti Alain Plantey, ndër të tjera përmendi tiparet kryesore të personalitetit të Ismail Kadaresë dhe të

veprës së tij, cilësitë e të cilave vlerësohen kudo. "Në rast se ju jeni në mënyrë të pakundërshtueshme një shkrimtar, tha ai, veprat tuaja kanë, në gjithë botën, një kuptim të fuqishëm...Duke ju zgjedhur juve, ne caktojmë natyrisht një European të një soji të veçantë, një Ballkanik, që për më tepër është shqiptar, përfaqësues i shquar i një prej Kombeve dhe prej kulturave më autentike ballkanike. Në rast se sot, si për shumë në Europën Qëndrore dhe Ballkanike, Shqipëria sheh drejt Perëndimit liberal, ky Perëndim, nga i cili në të vërtetë komunizmi kishte frikë, kjo është pikërisht në sajë tuajën. Ju keni treguar fuqinë etike dhe politike të mesazhit letrar, kur ai mbështetet në kurajon dhe talentin. Vendi juaj është ashtu si duket midis nesh.

Pastaj, ai ja dha fjalën anëtarit të Akademisë, Zotit Henri Amouroux, i cili ndër të tjera theksoi:

"Cilin po pranojmë ne sot: romancierin Ismail Kadare, njërin nga më të mëdhejtë të kohës sonë...Por në 1989, Ismail Kadare ka qënë zgjedhur anëtar korespondent i seksionit të historisë dhe gjeografisë të Akademisë sonë. Një romancier në seksionin tonë të historisë dhe gjeografisë? Më kujtohet atëhere, Ismail, se u thashë kolegëve të mij, i bindur menjëherë se e gjithë vepra juaj ishte e pandarë nga gjeografia e një vendi që Ptolemeu, i pari,

e quajti Albanoi, emër që mendohet se ai i referohej në këtë mënyrë maleve, këtyre maleve, që zënë dy të tretat e territorit, që ishin strehë jo vetëm e të gjitha rezistencave ndaj të gjithë pushtuesve, por gjithashtu e muzikës, valleve, kostumeve, dhe ajo që është kryesorja e gjuhës shqipe".

Mjafton kaq për të respektuar Ismail Kadarenë, i cilësuar „fenonem“, një shqiptar bashkëbesëlidhës i yni, pasi duam as nuk duam, ai është i respektuar nga njerëz modestë, letrarë, shkrimtarë, historianë, shkencëtarë, por edhe Presidentë të botës mbarë.

Të heq Kapelen miku im i mirë, modest, por penë artë, Ismail dhe ty Helenë që ke qëndruar gjithmonë pranë tij në Shqipëri, Francë e gjetiu, ku ju kanë shpënë rrugët e jetës, si në Guernessey për Hygoin ka qënë Zhulieta dhe për Soljenicinin ka qënë Matriona. Ju keni qënë për të "një mbështetje edhe në çastet më të errëta të vetmisë dhe të braktisjes", por edhe në çastet dhuratë të lavdisë së tij të merituar të sotme. Së bashku ne do bëjmë çmos dhe do ndikojmë që Njeriu ynë i Madh, Ismail Kadare të marrë faktikisht çmimin "Nobel" që e ka merituar prej kohësh.

Gjenevë, më 22 korrik 2019

## poezi \*\*\* poezi \*\*\* poezi \*\*\* poezi \*\*\* poezi\*\*\* poezi \*\*\* poezi\*\*\* poezi \*\*\* poezi

## GAZETA "DUKAGJINI"

Shfletova e lexova artikujt e gazetës "Dukagjini"  
Artikuj që japin kulture nga djepi i kulturës,  
Atje ku maleve u rrjedhin lotët mallëngjimi ...  
Nga ku vërshuan luftërat dhe tingujt e muzës.

Shfletova e lexova historinë e trevës së hekurit!  
E djepin që rriti diva ... shekujve mbi krep,  
Ku fusha e kujtofolkut respekton të vdekurit  
Ligjërojnë thëniet e tyre thellë popullit të vet.

Eh, Dukagjin mitologjik me nëntë fëmijë ...  
Nëntë flamujt e tua janë shëmbëlltore sfide,  
Ngaqë vdekja t' u duk luks në front ty për liri  
Ndaj vrullshëm si shkabe zemërate u ngrite.

Kam dëgjuar për qëndresën tënde konsekuente,  
E pa konvertuar, statike ke qëndruar ndër mote  
Mister, fjalët dhe tingujt e telit që ti ende ...  
Dhe këngët si lulet e pranverës, nga bota jote.

I kam parë edhe ndjere trevesat tua bujare, festive,  
Evenimentet e bukura, tërheqëse dhe të rralla!  
Dhe shpirtin tënd dedikues përkushtuar yjeve ...  
Aty, ku rreth vatrës së lashtë frymëzim është fjala.

Shfletova e lexova artikujt e gazetës dhe autoret  
Financuesit e kulturës me zemër të madhe,  
Kështu kuptova që shpirti për trevën s' u lodhët,  
I Shenjtë është kontributi i kullave ... mbi male.

Shfletova dhe ndesha për çudi dhe emrin tim,  
Se si pranë jush, unë një thërrime e vogël!  
Shkëputur e rënë si pupël harabeli në fluturim  
Nëpërmjet hiperbolës suaj mbeta diku në kodër!

Respekt për redaksinë e gazetës plot vullnet e pasion  
Dhe për lëvruesit, që përbejnë fushë universale ...  
Si dhe për zërin e Dukagjinit që horizontit vibron,  
Dhe për fshikullimën që u bën regjimeve fatale.

I tillë mbetesh Dukagjin për bijtë e tu gjithmonë  
Ke qenë, je dhe do të jesh sikundër dje, Apogje,  
Lidhur diku me gjakun tënd hero i kombit tone ...  
Paçka se besa jote e dhënë krah tij, ishte rufe!

Respekt për malet e larta që s' reshten së gjëmuari  
Nga jehona e pushkës, e këngës dh' e penës ...  
Mitin tënd të lashtë në palcë të vet mban guri,  
Sikundër, lulet e bjeshkës aromat mes fletës.

Respekt për gjithë ata që i thurën dhe i thurin ...  
Mbase jo vjershë të lehte si unë, po varg poetik  
Pasardhësit e trevës që më të mprehtë kanë trurin,  
Dukagjin me flamuj ... e gjithëcka tjetër, unik!

Shfletova e lexova artikujt e gazetës "Dukagjini"  
Artikuj të ndryshëm me gjuhë, stil, relaks ...  
Që aq bukur t' i rrjedhin elitës tënde si Drini ...  
Ngaqë përbrenda kokës tek buza jote, plot gaz!

Dukagjin, ti ke se ç' u tregon shekujve që vijnë!  
Qe nga gjeneza jote të tashmes e të ardhmes,  
Armata e krishterimit ... ku lisa bien e mbijnë ...  
Në panteonin legjendar nga shtrati i së lashtës.

Në gazetën tonë keni trajtuar traditat fisnore  
Ritet e brezave në rrjedhën e shekujve, historisë  
I keni dhënë pa mëdyshje të vërtetën njerëzore,  
Flamurit ngjyrën e gjakut dhe nderin e Shqipërisë.

Keni trajtuar probleme sociale të shoqërisë sonë  
Fushat e mozaikut kulturor të malësorëve tanë,  
Ku me fjali te thjeshte, ku me varg dellëror ...  
Datat gdhendur në qemerë gurësh ende janë.

Ziejnë malet e larta në timbrin e lahutës tënde,  
Kuja e dikurshme vërshoi me lot e "Gjama" dridhi,  
Luftërat këmba-këmbës të ndoqën, ë s' u trembe  
Se me shenjën e Dragonjve në djep nëna të rriti.

Sot, në shekullin modern përballësh me pinjollët,  
Me ata që të shkelën e që duan te të shkllasin ...  
S' bëre sehir askurrë dhe as nuk the s' më folët,  
Flasim, shkruajmë e kërkojmë dhe sikur të pëlcasin ...

Flasim e kërkojmë të domosdoshmen e logjikshme,  
Të arsyeshmen njerëzore para Zotit e njeriut në tokë  
Çdo gjë që është e drejtë, çdo gjë që është e ligjshme  
Pa u skuqur faqeve aspak, këtu e kudo nëpër botë.

T' i pushkatuan klerikët ngaqë nuk shkelen betimin  
Dhe intelektualët e pajisur me karakter të lartë,  
Mbërthyer me hekura, lidhur ta mbajtën frymëzimin  
Gjersa shpërtheu si vullkan bota jote e artë!

Në gazetën tënde Dukagjin mitik, hynë dhe dasmat  
Hynë krushqit e rreshtuar, dhëndurët dhe nusët,  
Dhe këngët e riteve, lojërat e bukura me maskat ...  
Përzier me folklorin e derdhur vijueshëm nga buzët.

Dhe më, rritesh përditë si një bastion i shenjte ...  
Akumulohen rreth teje, mjeke, profesorë, shkrimtare,  
Dukagjin, ata qe me te pare u dhe shprese e jete  
Shtresës me autoktone të popullit shqiptar ...

E madhërishtme zgjohesh përditë e kthjellët e dinjitoze  
Mbi fletët e veprave nga ku nxjerr mësimet e jetës,  
Media e shtypit tuaj e rrisin pikëpamjet rigoroze ...  
Dhe vlerat e fiseve fisnike që vijnë unik rreth besës.

Gazetën tonë e rrisin gurgullimat e krojeve mbi brigje  
Këmborët e tufave në faqet e bjeshkëve të larta  
Pret, siç priste Danten e madh e madhja Beatrice ...  
Nga udhët e lodhshme, ndërlike dhe të gjata!

Gazetën tonë e rrisin thinjat e burrave të zakonshëm  
Madhështia e thjeshtësisë përbrenda njeriut ...  
Që lind në të përkorën e rron në të përbotshmen  
Si malet e thepisura, nga ku shkëmbinjtë e veriut –

Krenohem për popullin tënd ardashës dhe bujar,  
Për kullat e vjetra me qemer edhe prag të skalitur,  
Si vjehri e vjehrra për një vajzë të mirë që zë për djalë  
A si për një djalë të shumëpritur kur kullës i ka lindur.

Krenar të shoh për bijtë e tu që ligjërojnë nëpër botë  
Me emrin tënd të lashtë e plot për ty,  
Anekënd ngrysën e zgjohen me Dukagjinin e ngrohtë  
Në gojë, në mendje, në shpirt u rreh në gji ...

Dhe unë ta lexoj në ballë për to krenarinë, gëzimin  
Që aq bukur ta ushqejnë harenë me përkushtim,  
Dhe ua vështror mënyrën, formën, idenë, obligimin,  
Dhe humanizmin financiar për Dukagjinin sublim.

Shfletoj, lexoj e dëgjoj këngët e bilbilave që ti mbart  
Në gazeta e libra, në ngjarje përvjetorësh, në pemë,  
Zëri yt përzier me të kanarinës në natyre përbën art,  
Si oxhaku dimëror, kripa në gjollë, a misri në lëmë ...

Eh Dukagjin! Të lindën e të rritën në djepin e legjendës!  
Si Rozafatin e Shkodrës bedenat e hershme, sumatra  
Kështu, Dalmatet Iliriane, për nga shekujt pararendës,  
E vërteta artikuluese e gazetareskes dëshmon thënie t' arta.

Kanuni i Leke Dukagjinit qe kështjellë morale e drejtësisë  
I parapriu te tashmes aktuale, statuteve, kodifikimeve,  
Normat disiplinore, rregullat përbënin fortesën e fuqisë  
Nga ligjet e sotme, ndofta më të shenjta ishin ato shkrime.

Shfletoj e ndalëm te vargjet poetike të poetëve tu  
Që aq bukur timbërojnë nga gjuha e stili, fonema, rima,  
Fjalitë e ndërtuara me parametra sintaksore nga ju!  
Me metrike komplekse, të telajta e plot figurina ...

Ndesha në gazetën tënde Dukagjin, fushat e larmishme  
Alegorinë spirituale, tyrjelëse e piastërike të zhanreve  
Pragmatiken e normalizuar, konciz e të vetëdijshme,  
Me polisindet gjuhësor nga dialektika uniformë e Alpeve.

Shfletova e lexova për kullën tënde që priti e përcolli  
Me ditë, me javë, me muaj, me vite, e shekull me shekull,  
Udhëtari, guximin e luanit dhe urtinë, malesh tua mori,  
Nga trevesa mësimi i dhe mikut, ndërsa armikut hekur.

Zërin e bjeshkëve dhe vallen e logjeve u dhe përvjetorëve  
Atmosferën shtojzovalleve, eventimeve publike,  
Aq sa ziejnë si vullkan dhe grykat dhe malet e malësorëve,  
Nga trualli i fisnikëve të mëdhenj dhe nënave fisnike!

Lexojmë të t' përshëndes për huret tua të lashta dhe të reja  
Për artin që raca jote vijon ta dëshmojë me guxim,  
Për stoicizmin e besimit të krishterë në mote dhe tjera ...  
Për arat me misërishte, si fushe me lule për çdo burim.

Për kopshtin me duhan të kuq të plakut me qeleshe shajak'  
Dhe me mustaqe të ngjyrt nga tymi i duhanit, barut,  
Për tirq' e xhamadan e fasuletë, kuti mademi-jatak,  
Për kallot e duarve të punës dhe për fytyrën tënde pa luk.

Faqeve tua pranoni vargjet e mia gazetë e ngrohtë zonale  
Të thjeshta, ashtu siç je dhe vete Dukagjin për nga natyra,  
E thjeshte dhe madhërishtme, shandan që ndrit mbi male!  
Nga karakteri kristal të ndrit balli i mendimit dhe fytyra.

Shfletoj e lexoj udhët e tua të gjata e të vështira mbi shkrep  
Historinë që kushdo e dëgjon rrëqethet ndodhurave seri,  
Të përballosh vështirësi të tilla, ndofta në jetë të solli jeta,  
Sikundër gazetën "Dukagjini", që të rrefsh ti vetë çdo histori!

Ti flet me gjuhën universale të inteligjencës së kohërave  
Elita jote u farkëtua në panteonin e kulturës ziliqare ...  
Modernizmin ke sinkronizuar me rregullat e zakoneve,  
Në pasqyrën e shtypit tënd mujor gazeta jonë krenare.

Urime redaksisë dhe kontributorëve që dhe të rrisin e të çmojnë  
Njëkohësisht lexuesve që s' reshtin së lexuari "Dukagjinin"  
I bindur jam që sot, se kaq vargje për një media s' mjaftojnë,  
Pune të mbare, ju që na sillni nga majat e larta burimin ...

Autori **KOLE KODRA**

## REDAKSIA

**Kryeredaktore: Suela Ndoja**  
**Redaktorë: Luigj Shyti, Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani,**  
**Lazër Kodra, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja, Kole Çardaku,**  
**Eilda Delija, Age Martini, Klodiana Serraj, Vilson Peshkaj,**  
**Marijan Ndershtiqaj, Arber Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza e**  
**Ndue Ziçi.**

Mundësoi Botimin:  
**KOLË ÇARDAKU**

